

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6783  
E enjte, 15 dhjetor 2022  
çmimi 0.40 €

## Escobari: Do ta kemi Asociacionin



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

UDHËHEQËSIT E INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS KANË NËNSHKRUAR KËRKESËN PËR ANËTARËSIM NË BASHKIMIN EVROPIAN, E CILA SOT DO T'I DORËZOHET ZYRTARISHT ÇEKISË SI KRYESUESE E RADHËS E BLOKUT 27 ANËTARËSH

### AKTUALE



LIROHEN 64 UKRAINAS DHE NJË AMERIKAN NË KËMBIMIN E TË BURGOSURVE ME RUSINË

DRENASI SHPALL 'QYTETAR NDERI' TRE ISH-PRESIDENTËT E SHQIPËRISË

MUSLIU DHE QALAJ: LV-ja PO E BOJKOTON PROJEKTLIGJIN PËR PENSIONET E ZYRTARËVE POLICORË

### EKONOMI



GJERMANIA NË KËRKIM TË PUNËTORËVE TË HUAJ

HAJDARI THOTË KOSOVA KA PËRPARËSI TË SHUMTA PËR INVESTIME TË HUAJA

### SPORT



LICENCOHEN FEDERATA E MUNDJES DHE E TRIATHLONIT

# KOSOVA NËNSHKRUAN APLIKIMIN PËR ANËTARËSIM NË BE



Udhëheqësit e Kosovës, Vjosa Osmani, Glauk Konjufca dhe Albin Kurti, kanë nënshkruar të mërkurën aplikimin për anëtarësim në BE. Ky aplikim

pritet të dorëzohet më 15 dhjetor në Republikën Çeke, e cila aktualisht kryeson Presidentcën e BE-së. Presidentja Osmani ka thënë ka thënë se nga sot e tutje

14 dhjetori merr një tjetër peshë si datë historike, ndërsa nënvizoi vendosmërinë e institucioneve për ta përmbyllur me sukses këtë proces



ÇITAKU: GËNJESHTRAT E BORRELLIT E VËRTETOJNË POLITIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR KUNDËR ISH-KRERËVE TË UÇK-së

FILLON FUSHATA "PËR KOSOVËN PA KORRUPSIONIN"



**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVE  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Lirohen 64 ukrainas dhe një amerikan në këmbimin e të burgosurve me Rusinë

KIEV, 14 DHJETOR - Kievi ka njoftuar më 14 dhjetor se kishte siguruar lirimin e 64 trupave ukrainase dhe një qytetari amerikan në këmbimin e fundit të të burgosurve me Moskën. "Janë 64 ushtarë të Forcave të Armatosura të Ukrainës që luftuan në Donjeck dhe Luhansk, veçanërisht në mbrojtjen e Bakmutit që po kthehen në shtëpi. U bë gjithashtu e mundur që të lirohet edhe një shtetas amerikan, i cili ndihmoi popullin

tonë - Suedi Murekezi", ka shkruar në mediet sociale Andriy Yermak, shefi i zyrës së presidentit të Ukrainës.

Ukraina dhe Rusia kanë këmbyer një numër të madh të të burgosurve të luftës, që nga nisja e saj në shkurt. Presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, tha në fillim të dhjetorit se mbi 1 300 të burgosur janë kthyer në Ukrainë, që kur trupat ruse nisën pushtimin e vendit. Në një takim me Kryqin e Kuq në tetor, Rusia

tha se mbante rreth 6 000 robër luftime ukrainas.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt.

Presidenti Putin e quan luftën si "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Ruisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.



## Kina ndryshon politikën e raportimit të rasteve me koronavirus

PEKIN, 14 DHJETOR - Komisioni Kombëtar Shëndetësor i Kinës, duke filluar nga 14 dhjetori, ka ndryshuar mënyrën e raportimit të rasteve me Covid-19, pas rënies së numrit të testeve me metodën PCR, qëkur qeveria ka lehtësuar masat kundër pandemisë. Në njoftimin e këtij Komisioni u tha se nuk do të publikohen shifra ditore të rasteve me Covid-19 në rastet kur të infektuarit nuk kanë simptoma, pasi "është e pamundur të dihet me saktësi numri i personave të infektuar asimptomatikë", të cilët në përgjithësi përbëjnë shumicën e infeksioneve të reja. Të vetmet numra që do të raportohen do të jenë rastet e konfirmuara, që zbulohen në qendrat publike të



testeve.

Kjo përbën sfida për Kinën, shtet që po lehtëson masat e saj të rrepta të quajtur "zero-Covid". Më testimi masiv me PCR nuk është i

detyrueshëm dhe qytetarët me simptoma të lehta lejohet që të qëndrojnë në shtëpi derisa të shërohen dhe jo të shkojnë në spitale. Këto ndryshime

politikash vlerësohet se do ta vështirësojnë numrin e saktë të rasteve me koronavirus.

Pavarësisht se autoritetet kanë deklaruar se kanë siguruar farmaceute të shpejta antigjen për Covid-19 për farmacitë në Pekin, këto lloje testesh raportohet se vështirë gjenden në farmaci.

Pa numërimin e rasteve asimptomatike, Kina ka raportuar 2 249 raste të konfirmuara të mërkurën, duke bërë që numri total i rasteve të arrijë në 369 918 që është më shumë se dyfishi i numrit të raportuar më 1 tetor. Ky shtet ka raportuar 5 235 vdekje, që është numër shumë më i vogël sesa 1.1 milion vdekje që kanë raportuar Shtetet e Bashkuara.

Shifrat e Covid-it të raportuara nga qeveria kineze nuk kanë mundur të konfirmohen në mënyrë të pavarur dhe janë ngritur pyetje nëse Partia Komuniste ka tentuar ta zvogëlojë numrin e rasteve dhe vdekjeve.

Kina, po ashtu, do të lehtësojë edhe disa masa kundër pandemisë, pas pothuajse tre vjetësh masa të ashpra.

Muajin e kaluar Pekini dhe disa qytete të tjera u përballën me protesta lidhur me masat e ashpra të qeverisë. Protestuesit kërkuan që presidenti Xi Jinping dhe Partia Komuniste të japin dorëheqje. Këto protesta ishin më të mëdhatë që ky shtet ka parë ndër dekada. Autoritetet u përgjigjën duke arrestuar një numër të paspecifikuar të protestuesve.

## Scholz: Anëtarësimi i vendeve të Ballkanit në BE, në interes të Gjermanisë

Berlin, 14 dhjetor - Në një fjalim në parlamentin gjerman, kancelari Olaf Scholz ka thënë se është në interesin e Gjermanisë dhe Evropës që vendet e Ballkanit Perëndimor të anëtarësohen në Bashkimin Evropian. Ai përshëndeti shtimin e angazhimit të BE-së me gjashtë vendet e rajonit, ndërsa vlerësoi vendimet për t'i dhënë Bosnjë-Hercegovinës statusin e kandidatit dhe futjen e Kroacisë në zonën e Shengenit.

Scholz i bëri këto komente në fjalimin e tij në parlament, para takimit të nivelit të lartë të bllokut me 27 anëtarë në Bruksel. "Është në interesin gjerman dhe evropian që pjesa e mbetur e Ballkanit të bëhet pjesë e Bashkimit Evropian", ka deklaruar Scholz para ligjvënësve në Berlin.

Për momentin gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor ndodhen në faza të ndryshme në aspiratën e tyre për anëtarësim në familjen e madhe evropiane.

Kancelari gjerman vlerësoi vendimin për futjen e Kroacisë në zonën evropiane të udhëtimit pa kontrolle, e njohur si zona Shengen.

"Është, po ashtu, në interesin tonë që nga viti 2023 Kroacia të jetë pjesë e zonës Schengen", ka deklaruar Scholz.

Ai ka theksuar se njësoj duhet të veprohet edhe me Bullgarinë dhe Rumaninë, përfshirja e të cilave në zonën Schengen u bllokua javën e kaluar nga Austria.

Gjatë viteve të fundit procesi i zgjerimit të Bashkimit Evropian nuk ka shënuar ndonjë përparim, por pas sulmit rus në Ukrainë në fund të shkurtit, zyrtarët e BE-së kanë theksuar se rritja e angazhimit të bllokut me vendet e Ballkanit është jetik për sigurinë në Evropë.

Kancelari gjerman ka pohuar se mbështetja për Kievin dhe sanksionet kundër Moskës do të vazhdojnë të shtohen për aq kohë sa presidenti Vladimir Putin vazhdon luftën e tij kundër Ukrainës.



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere\_mm@hotmail.com & mm\_epokaere@yahoo.com

# Musliu dhe Qalaj: LV-ja po e bojkoton Projektligjin për pensionet e zyrtarëve policorë

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Ganimete Musliu dhe Rashit Qalaj, përmes një konference për medie i kanë akuzuar deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje për dështimin e Projektligjit për Pensionet e Zyrtarëve Policorë në Komisionin për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes.

Deputetja Ganimete Musliu ka thënë se bojkotimi i këtij projektligji nga ana e partisë në pushtet po ndodh sepse këtë projektligj e ka hartuar Partia Demokratike e Kosovës. “Sot përmes kësaj konference kemi dalë që ta shprehim shqetësimin tonë të thellë lidhur me dështimin tri herë radhazi të Komisionit për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, për të proceduar me Projektligjin nr. 08/L-160 që rregullon pensionet e zyrtarëve policorë të Policisë së Kosovës dhe punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës me autorizime policore. Që nga 17 nëntori 2022, me bojkotimin e Lëvizjes Vetëvendosje në tri mbledhje radhazi, është pamundësuar kuorumi që të votohet në parim ky projektligj dhe t’i dërgohet seancës. Ky bojkotim i partisë në pushtet erdhi vetëm nga inati se këtë projektligj për Policinë e Kosovës e ka hartuar Partia Demokratike e Kosovës”, ka thënë ajo.

Musliu ka njoftuar se me këtë projektligj janë propozuar katër lloje të pensioneve: i rregullt, invalidor, familjar dhe vullnetar. “Përmes tij do të rregullohen dhe



përcaktohen kushtet dhe kriteret për garantimin e pensioneve, llojet e pensioneve, si dhe përcakton kategorizimin e pensioneve për pensionin për zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës dhe punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës me autorizime policore dhe familjarët e tyre. Me këtë Projektligj janë propozuar katër lloje të pensioneve: pensioni i rregullt, invalidor, familjar dhe vullnetar”, ka thënë ajo.

PDK-ja i ka bërë thirrje qeverisë Kurti dhe deputetëve të Vetëvendosjes që t’i lënë anash inatet politike dhe ta mbështesin

miratimin e këtij projektligji në Kuvendin e Kosovës. “Kuraja dhe angazhimi që ata kanë treguar së fundmi është tregues i qartë se ne kemi zyrtarë të gatshëm për ta garantuar funksionimin e shtetit ligjor në tërë territorin tonë. Por, gjithçka që u duhet është mbështetja e pazezërvë e Qeverisë së Kosovës ndaj tyre. Mosplotësimi i tërësishëm i nevojave dhe kërkesave të Policisë së Kosovës deri më tani është shqetësues. Ne kërkojmë që urgjentisht dhe pa vonesa, qeveria të sigurojë gjithçka që duhet, që policët tanë të kenë kushtet e nevojshme për ta

zbatuar rendin dhe ligjin në pjesën veriore të Kosovës”, ka theksuar Musliu.

Ndërkaq deputeti Rashit Qalaj ka thënë se PDK-ja do të insistojë që ky projektligj të kalojë. “Ky ligj t’i mundësojë Policisë së Kosovës që t’i rrisë kapacitetet operacionale të saj gjithmonë duke pasur në konsideratë që policët e Kosovës që janë në moshë të shtyrë dhe ata me sëmundje të rënda të dalin sa më shpejt në pension, ta kenë një pension të dinjitetshëm dhe gradualisht me pensionimin e tyre të rekrutohen gjenerata të reja të kadetëve policorë në Policinë e

Kosovës”, ka thënë Qalaj. Po ashtu, PDK-ja kërkon që qeveria të mendojë urgjentisht për sigurimin jetësor dhe sigurimin shëndetësor të Policisë së Kosovës. “Përveç Ligjit për Pensionim të Parakohshëm të mendojë urgjentisht për sigurimin jetësor dhe sigurimin shëndetësor, gjithmonë duke pasur parasysh gjendjen që e kemi sot, angazhimin e policisë, sidomos në komunat veriore të vendit, angazhimin e tyre me orar të zgjatur dhe në kushte shumë të rrezikshme për jetën dhe shëndetin e tyre”, ka theksuar Qalaj.

## Fillon fushata “Për Kosovën pa korrupsion”

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, e mbështetur nga Bashkimi Evropian në Kosovë, ka filluar të

mërkurën një fushatë për informimin e publikut e cila promovon rolin e saj në kontrollin e deklarimit të pasurisë nga zyrtarët, parandalimin e konfliktit të interesit si dhe hetimin e raporteve të sinjalizimit.

Fushata e quajtur “Për Kosovën pa korrupsion”, e cila i bën thirrje publikut ta raportojë korrupsionin, fillon pas miratimit të ligjeve të reja të cilat e forcuan mandatin e Agjencisë duke i dhënë kompetenca dhe detyra

shtesë, përfshirë sanksionimin e drejtpërdrejtë të zyrtarëve dhe vlerësimin e hapësirave për korrupsion në legjislacion. “Legjislacioni i ri qartëson mandatin parandalues të Agjencisë si dhe e pajisë atë me mjete thelbësore për parandalimin e korrupsionit. Për më tepër, roli i pranisë së BE-së në Kosovë, përkritazi me përpjekjet e institucioneve të Kosovës kundër korrupsionit, është vendimtar”, ka thënë drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, Yll Buleshkaj.

Me mbështetjen e Bashkimit Evropian në Kosovë, kjo fushatë do të përfshijë pesë video dhe një broshurë të cilat ofrojnë informata për mandatin e Agjencisë, mënyrat se si publiku mund ta raportojë korrupsionin si dhe për gjobat dhe sanksionet me të cilat mund të përballen zyrtarët dhe institucionet nëse nuk e respektojnë ligjin. “BE-ja e mbështet Kosovën në luftën kundër korrupsionit me qëllim që ta ndihmojë të afrohet me BE-në.

Sigurimi i sundimit të ligjit është qëllimi ynë i përbashkët dhe ne do të vazhdojmë ta mbështesim punën e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, duke përfshirë edhe këtë fushatë. Ne ishëm të lumtur ta mirëpresim miratimin nga Kuvendi i Kosovës në fillim të kësaj vere të disa ligjeve kyçe për parandalimin e korrupsionit nga Kuvendi, përfshirë këtu edhe Ligjin për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Ligjin për Deklarimin e Pasurisë. Të dyja këto ligje janë pjesë e Agjendës së Reformave Evropiane të Kosovës. Tani është koha për zbatimin e plotë të tyre dhe për t’ia ndarë Agjencisë të gjitha burimet që i nevojiten për zbatimin e mandatit të saj”, ka theksuar ambasadori i BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog. BE-ja në Kosovë është duke punuar si me legjislativin edhe me ekzekutivin për të ndihmuar në harmonizimin e ligjeve dhe praktikave të Kosovës me ato të BE-së si pjesë e procesit të integritimit në BE.



UDHËHEQËSIT E INSTITUCIONEVE TË KOSOVËS KANË NËNSHKRUAR KËRKESËN PËR ANËTARËSIM NË BASHKIMIN EVROPIAN, E CILA SOT DO T'I DORËZOHET ZYRTARISHT ÇEKISË SI KRYESUESE E RADHËS E BLOKUT 27-ANËTARËSH

# Kosova nënshkruan aplikimin për anëtarësim në BE

Udhëheqësit e Kosovës, Vjosa Osmani, Glauk Konjufca dhe Albin Kurti, kanë nënshkruar të mërkurën aplikimin për anëtarësim në BE. Ky aplikim pritet të dorëzohet më 15 dhjetor në Republikën Çeke, e cila aktualisht kryeson Presidencën e BE-së. Presidentja Osmani ka thënë ka thënë se nga sot e tutje 14 dhjetori merr një tjetër peshë si datë historike, ndërsa nënvizoi vendosmërinë e institucioneve për ta përmbyllur me sukses këtë proces

**EPOKA  
ERE**

**Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 14 DHJETOR** - Krerët shtetërorë të Kosovës kanë nënshkruar aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Aplikimi u nënshkrua të mërkurën nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca dhe kryeministri Albin Kurti. Presidentja Osmani e cilësoi historik nënshkrimin e aplikimit të anëtarësimit në bllokun evropian. "Po marrim një hap vendimtar drejt jetësimit të ëndrrës sonë kolektive e ambicies sonë të patjetërsueshme", ka thënë Osmani, duke shtuar se aplikimi

për anëtarësim në BE është një hap drejt përmbylljes së ambicieve evropiane të Kosovës. Dorëzimi i aplikimit pritet të bëhet më 15 dhjetor në Pragë të Çekisë, shtetit që aktualisht kryeson presidencën e bllokut evropian.

Presidentja Osmani ka theksuar se për Kosovën nuk ka pasur asnjëherë alternativë tjetër pos BE-së. "Kosova sot është mishërim i vlerave mbi të cilat është ndërtuar Bashkimi Evropian dhe frymon me shpirtin evropian", është shprehur ajo, duke theksuar se shteti meriton të jetë pjesë e BE-së. "Rruga jonë përpara është e qartë, procesi i anëtarësimit në BE nuk është i njëtrajtshëm dhe

procesi në tërësi mund të jetë afatgjatë. Por, ne jemi të vendosur që t'ia dalim me sukses", ka deklaruar Osmani. Kryeparlamentari Konjufca ka thënë se për Kosovën dhe rajonin e Ballkanit Perëndimor anëtarësimi në BE është i rëndësishëm sepse, sipas tij, blloku ofron stabilitet, siguri, demokraci dhe prosperitet zhvillimor. Ai ka thënë se pret që pas dorëzimit të aplikimit, Komisioni Evropian ta rekomandojë dhënien e statusit të vendit kandidat, më pas shtetet anëtare të bllokut ta mbështesin anëtarësimin e Kosovës. "Marrja e statusit të vendit kandidat ka peshë të konsiderueshme dhe me të drejtë konsiderohet si vula e parë e perspektivës evropiane. Për këtë arsye, e ftojme Parlamentin Evropian, Këshillin Evropian, Komisionin Evropian dhe shtetet anëtare të BE-së, që ta demonstrojnë përkushtimin dhe përkrahjen e tyre ndaj Kosovës, por edhe të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor, duke e miratuar unanimisht kërkesën e Kosovës për anëtarësim", ka deklaruar Konjufca.

Kryeministri Kurti ka thënë se ky moment historik synon hapjen e një kapitulli të ri për shtetin e Kosovës. "Sot po bëjmë hapin e parë drejt anëtarësimit në organizatën më të madhe të paqes dhe prosperitetit në Evropë, Bashkimin Evropian. Aplikimin për anëtarësim në Bashkimin Evropian të nënshkruar sot nga krerët e institucioneve të Republikës sonë do t'ia dorëzojmë Presidencës Çeke të Këshillit të Bashkimit Evropian në Pragë. Është ky një moment historik për vendin tonë që synon hapjen e një kapitulli të ri për shtetin dhe për shoqërinë tonë. Progresi do të varet nga përkushtimi ynë për reforma të thella dhe transformuese të cilat e avancojnë demokracinë, e forcojnë sundimin e ligjit dhe e zhvillojnë ekonominë tonë", ka thënë Kurti, duke shtuar se shpejtësia me të cilën do të ecin do të varet nga institucionet e Kosovës. "Prandaj, angazhimi i të gjithëve është i nevojshëm e përkushtimi i secilit, i domosdoshëm. Ne do të ecim përpara në meritën tonë. Pra, në aftësinë tonë për t'i përmbyllur kriteret në secilin kapitull të ri.

Pengesat dhe sfidat drejt anëtarësimit i kalojmë me zhvillim demokratik dhe me progres shoqëror. Së bashku, në këto dy vjet kemi dëshmuar që kur shpresojmë dhe besojmë, çdo gjë është e mundur dhe nuk ka pengesë që nuk e kalojmë", është shprehur Kurti.

Kosova deri më tani ka vetëm një marrëveshje kontraktuale me BE-në, përkatësisht Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit.

Nga 27 shtetet anëtare të bllokut, pesë prej tyre ende nuk e njohin pavarësinë e Kosovës. Shtetet mosnjohëse janë: Spanja, Rumania, Qiproja, Greqia dhe Sllovakia.

Nga shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, Serbia dhe Mali i Zi janë dy shtetet që kanë bërë më shumë përparim drejt anëtarësimit në bllok, pasi deri më tani kanë hapur disa kapituj në bisedimet për anëtarësim.

Maqedonia e Veriut dhe Shqipëria gjatë këtij viti nisën procesin e bisedimeve, ndërkaq Bosnjë-Hercegovina këtë javë ka marrë statusin e vendit kandidat. Kosova, po ashtu, është shteti i vetëm që nuk ka liberalizim të vizave me BE-në.

## Escobari: Do ta kemi Asociacionin

PRISHTINË, 14 DHJETOR - I dërguari i posaçëm amerikan për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se formimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë është obligim si për Kosovën dhe Serbinë, ashtu edhe për BE-në që ka ndërmjetësuar negociimin e tij. “Ne do ta kemi Asociacionin. Ne do të jemi pjesë e procesit. Ai

proces duhet ta përfshijë Qeverinë e Kosovës. Nëse jo, ne mund ta zhvillojmë atë diskutim me partnerë alternativë, me shoqërinë civile, me grupet e të rinjve, me komunitetin e biznesit, me të gjithë që do të donin ta shihnin Serbinë dhe Kosovën duke dalë nga ky cikël i jostabilitetit”, ka deklaruar Escobari në një intervistë për

“Radion Evropa e Lirë”.

Ai ka thënë se duhet të punohet menjëherë për Asociacionin. “Duhet të jetë në agjendë për diskutimin e radhës. Ne duhet të mendojmë se si ta përdorim atë për të krijuar besim në mes të qeverisë dhe komunitetit minoritar. Kjo nuk ka të bëjë me Serbinë. Kjo ka të bëjë me marrëdhënien ndërmjet

qeverisë dhe komunitetit minoritar, në kuadër të strukturës kushtetuese të Kosovës dhe plotësisht sipas ligjeve të Kosovës”, ka theksuar ai.

Ish-kryenegociatorja e Kosovës në dialogun Kosovë - Serbi, Edita Tahiri, ka komentuar vizitën e të dërguarit të posaçëm të ShBA-së për Ballkanin Perëndimor,

Gabriel Escobar, në Prishtinë. Sipas Tahirit, Escobari menjëherë kërkon themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. “Escobari menjëherë kërkon Asociacionin. Siç po shihet, as përpjekja e fundit e Kurtit për ta shmangur nuk pati sukses, madje as ‘tymi nga veriu’ nuk e ndihmoi”, ka shkruar Tahiri në “Facebook”.



## Lajçaku: Pëlqej rrugë diplomatike për heqjen e barrikadave në veri

Prishtinë, 14 dhjetor - I dërguari i Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, ka thënë se pëlqen rrugën diplomatike për heqjen e barrikadave në veri dhe jo përmes buldozerëve. Ai i ka bërë këto deklarata pas një takimi që ka zhvilluar në Prishtinë me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti dhe të dërguarin e Shteteve të Bashkuara për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar. “Kam pasur diskutim të gjatë me [kryeministrin e Kosovës, Albin] Kurti. Nuk do t’i bëj publike detajet, sepse jam në mes të

misionit dhe do ta vazhdoj vizitën nesër në Beograd. Do të takohem me komandantin e KFOR-it dhe atë të EULEX-it sonte për ta parë vlerësimin e tyre për situatën në terren, më pas do të tentojmë t’i gjejmë zgjidhjet e mundshme, sepse kjo gjë nuk është e mirë. Unë nuk mendoj se kemi llogari që të presim për të ndodhur diçka e keqe. Tensionet nuk i ndihmojnë askujt dhe nuk mendoj që ndonjë njeri normal është i lumtur me këtë situatë në veri”, ka thënë Escobari para gazetarëve.



## Bordi Drejtues i Këshillit të Ambasadorëve Shqiptarë viziton Kurtin

PRISHTINË, 14 DHJETOR - Kryeministri Albin Kurti ka pritur të mërkurën në takim Bordin Drejtues të Këshillit të Ambasadorëve Shqiptarë (KASH), kryesuar nga ish-ministri i Punëve të Jashtme, Edmond Panariti. Duke biseduar për vendimin për aplikimin e Republikës së Kosovës në Bashkimin Evropian, kryeministri Kurti theksoi se i përgjigjet thirrjes

dhe aspiratave të qytetarëve të Republikës që thellësisht besojnë se e ardhmja e tyre është në Bashkimin Evropian. U theksua besimi se momenti është i duhur, duke marrë parasysh faktin se Kosova është vendi më demokratik në rajon. Delegacioni i Këshillit të Ambasadorëve Shqiptarë shprehu mbështetjen e pakursyer për Qeverinë e

Republikës së Kosovës. U bisedua për mundësitë e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të nismave në mbështetje të proceseve integruese të Republikës së Kosovës. Në këtë kontekst, Këshilli i Ambasadorëve Shqiptarë shprehu kënaqësinë dhe përkrahjen e plotë për aplikimin e Republikës së Kosovës për anëtarësim në Bashkimin Evropian.



## Nënshkruhet kontrata për sheshin qendror të Rahovecit



RAHOVEC, 14 DHJETOR - Komuna e Rahovecit ka njoftuar për nënshkrimin e kontratës për ndërtimin e sheshit qendror në këtë komunë në vlerë 3,817,347.79 euro. "Pas asistimit profesional në të gjitha fazat dhe procedurat ligjore deri te hapja e konkursit ndërkombëtar të projektimit, ku kanë aplikuar 80 studio të arkitekturës nga 37 vende të botës e të 5

kontinenteve, juria profesionale me tre anëtarë ndërkombëtarë e dy vendorë, me unanimitet ka vendosur për projektin e hartuar nga arkitektët: Thomas Boerendonk nga Holanda, Daniel Arce Chu nga Uruguai dhe Nguyen Duy Minh nga Vietnam, të cilët i kanë dhënë Rahovecit një dizajn ikonik dhe shumëfunksional, ashtu siç e kërkuan qytetarët e komunës

sonë", ka njoftuar komuna e Rahovecit. Përmes këtij projekti synohet që të kenë qasje në hapësira publike të sigurt, të shëndetshme dhe për të gjithë qytetarët, në veçanti për fëmijët, të moshuarit dhe personat me nevoja të veçanta. Gjithashtu, synohet edhe krijimi i mundësive të reja për biznes dhe rritja e cilësisë së jetës urbane.

## Drenasi shpall 'Qytetar Nderi' tre ish-presidentët e Shqipërisë



DRENAS, 14 DHJETOR - Komuna e Drenasit ka shpallur "Qytetar Nderi" ish-presidentët e Shqipërisë, Rexhep Meidani, Alfred Moisiu dhe Bamir Topi. Në ceremoninë solemne të Kuvendit Komunal të Drenasit kanë marrë pjesë edhe lideri i PDK-së, Memli Krasniqi, ai i AAK-së, Ramush Haradinaj dhe kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci. Me këtë rast, Haradinaj ka thënë se është mirënjohës për kontributin e tre ish-presidentëve të Shqipërisë dhënë për Kosovën. "I nderuar të jem i pranishëm në mbledhjen solemne të Kuvendit të komunës së Drenasit, me ç'rast u nderuan me titullin 'Qytetar Nderi' të kësaj komune ish-presidentët shqiptarë, Rexhep Meidani, Alfred Moisiu dhe Bamir Topi. Mirënjohës gjithmonë për kontributin e tyre nëpër procese të ndryshme për Kosovën dhe për angazhimin në funksion të fuqizimit të faktorit shqiptar", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".

## Pas tre vjetësh rikthehen shërbimet në Ambulancën e Mjekësisë Familjare në Qendrën e Studentëve

Prishtinë, 14 dhjetor - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka bërë me dije se pas tre vjetësh rikthehen shërbimet në Ambulancën e Mjekësisë

Familjare në Qendrën e Studentëve. "Përveç studentëve, kjo qendër u ofron shërbime mjekësore edhe qytetarëve të lagjeve përreth.

Vazhdojmë rritjen e shërbimeve dhe cilësisë së tyre për të gjithë qytetarët e kryeqytetit", ka shkruar Rama në "Facebook".



# Çitaku: Gënjeshtat e Borrellit e vërtetojnë politizimin e procesit gjyqësor kundër ish-krerëve të UÇK-së

PRISHTINË, 14 DHJETOR (ER) - Përfaqësuesi i Lartë i Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Josep Borrell, ka përmendur arrestimin e ish-presidentit Hashim Thaçi nga Gjykata Speciale, gjatë një fjalimi të tij në Forumin për Drejtat e Njeriut me temën "Ndaloni mosndëshkimin - rruga drejt llogaridhënies dhe drejtësisë". Ai tha se EULEX-i e ka arrestuar sa ishte president. "Ne po krijojmë mekanizma të veçantë për zgjidhjet post-konfliktit dhe këtu dua ta përmend Kosovën, Dhomat e Specializuara të Kosovës. Misioni ynë policor në Kosovë (EULEX) ishte i ngarkuar për ta arrestuar derisa ai ishte president dhe e dërguan atë në Amsterdam për t'u përballur me drejtësinë", ka deklaruar Borrelli.

Ndaj kësaj deklarate të Borrellit ka reaguar nënkryetarja e PDK-së, Vlora Çitaku. Ajo ka theksuar se gënjeshtat e Borrellit e vërtetojnë politizimin e procesit gjyqësor kundër ish-krerëve të UÇK-së. "Fillimisht, presidenti Thaçi ka dhënë dorëheqje si president i Republikës së Kosovës për t'u përballur me akuzat kundër tij. Ai asnjëherë nuk është arrestuar, por është vetëdorëzuar! Për më tepër, Dhomat e Specializuara nuk janë mekanizëm i BE-së, por i Kosovës. Deklaratat e Borrellit e dëshmojnë edhe një herë politizimin e skajshëm të procesit gjyqësor me të cilin po mundohen të krijojnë një balancë artificiale ndërmjet viktimave dhe agresorit", ka shkruar Çitaku në "Facebook".



## Policia hedh poshtë pretendimet se Pantiqit nuk i janë ofruar barnat e nevojshme



PRISHTINË, 14 DHJETOR - Policia e Kosovës tha se janë të pavërteta "spekulimet e personave të caktuar dhe disa medieve, kryesisht serbe", se ish-policit të arrestuar, Dejan Pantiq, autoritetet nuk i kanë ofruar barna mjekësore. "Ai është trajtuar mjaft mirë, konform rrethanave të krijuara dhe janë respektuar të drejtat njerëzore që i takojnë personit të ndaluar", tha policia, duke shtuar se i janë siguruar edhe barnat e nevojshme. Pantiq, ish-pjesëtar i Policisë së Kosovës, u arrestua më 10 dhjetor në pikëkalimin kufitar në Jarinjë. Autoritetet në Kosovë kanë thënë se Pantiqi dyshohet se ka

organizuar "sulmin terrorist" të 6 dhjetorit në zyrat e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në veri dhe ndaj zyrtarëve zgjedhorë e policorë. Andaj ndaj tij është shqiptuar masa e paraburgimit prej një muaji. Arrestimi i Pantiqit nxiti disa serbë lokalë që të ngrënë barrikada në veri më 10 dhjetor. Policia tha se situata e sigurisë në veri është e njëjtë, por shtoi se barrikadat dhe aktet e tjera kriminale po vështirësojnë punën e policisë dhe po cenojnë lirinë e lëvizjes së njerëzve dhe mallrave. Që nga 6 dhjetori, në verium e Kosovës, të banuar me shumicë serbe, janë shënuar një sërë

incidentesh me armë zjarri, granata dore e shok-bomba, por pa pasoja në njerëz. Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimi Evropian kanë kërkuar uljen e tensioneve dhe heqjen e barrikadave. Qeveria e Kosovës ka thënë se po pret që misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, t'i largojë barrikadat. Ky mision, ndërkaq, ka kërkuar që të shmanget çdo përshkallëzim i ri dhe që palët t'i zgjidhin çështjet përmes dialogut. Për shkak të barrikadave, autoritetet në Kosovë kanë mbyllur përkohësisht dy pikëkalimet kufitare me Serbinë: Jarinjë dhe Bërnjak.

## Zgjedhet kryesuesi dhe asamblistët e rinj të Mitrovicës së Veriut

MITROVICË, 14 DHJETOR - Nexhat Uglanin nga radhët e komunitetit boshnjak është zgjedhur kryesues i ri i Kuvendit Komunal të Mitrovicës së Veriut gjatë një mbledhjeje të mbajtur më 14 dhjetor. Po ashtu, 15 asamblistët të rinj dhanë betimin. Vetëm një është nga radhët e komunitetit serb. Ai është Dushan Millunoviq nga iniciativa qytetare "Mbijetesa serbe", ndërkaq dy të tjerë vijnë nga radhët e komunitetit boshnjak. Në fillim të muajit nëntor kryetarët e katër komunave në veri, që vinin nga radhët e Listës Serbe, por edhe kryetarët e Kuvendeve Komunale dhe asamblistët, dhanë dorëheqje. Asamblistët e rinj, sipas vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, do t'i zëvendësojnë asamblistët e

Listës Serbe që u dorëhoqën. Zyra për Kosovën në Qeverinë serbe ka reaguar pas betimit të asamblistëve të rinj, duke akuzuar se shqiptarët "me forcë ligjore dhe lëvizje të njëanshme morën" ulëset në Kuvendin Komunal. "Në këtë mënyrë [kryeministri i Kosovës, Albin] Kurti po përpiqet të krijojë një komunë të pastër monoetnike shqiptare në veri të Kosovës", u tha në reagimin e kësaj zyre. Zyrtarët serbë kishin dhënë dorëheqje në shenjë pakënaqësie me një vendim të Qeverisë së Kosovës lidhur me reregjistrimin e makinave me targa të lëshuara nga Serbia. Por, ndërkohë, Kosova dhe Serbia, me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, arritën një marrëveshje për targa. Për shkak të rritjes së



tensioneve në veri të Kosovës, zgjedhjet për kryetarë komunash dhe ato për kuvendin komunale në katër komunat në veri të Kosovës të parapara të mbaheshin më 18 dhe 25 dhjetor janë shtyrë për

në prill të vitit të ardhshëm. Që nga 6 dhjetori në verium e Kosovës, të banuar me shumicë serbe, janë rritur tensionet. Më 10 dhjetor disa serbë lokalë ngritën barrikada pas arrestimit të një ish-polici serb.

Për shkak të tensioneve, Policia e Kosovës ka shtuar praninë e saj në veri dhe autoritetet kanë mbyllur përkohësisht dy pikëkalimet kufitare me Serbinë, Jarinjë dhe Bërnjak. /REL

## Gjermania në kërkim të punëtorëve të huaj

**BERLIN, 14 DHJETOR** - Gjermania kërkon fuqi punëtore të kualifikuar, rreth 400 mijë vetë në vit. Adrian Oku nga Kavaja, instalues për sistemet e ngrohjes, ka ardhur enkas në Gjermani dhe ka shanse të mira të gjejë një punë në profesionin e tij.

Në Frankfurt ai pret në Qendrën e Mirëseardhjes për Fuqinë e Kualifikuar Punëtore nga Jashtë të landit të Hessenit, i veshur me xhup e kapuç.

Në zyrat gjermane nuk mbahet e ndezur shumë ngrohja këtë dimër. "Kërkoj punë këtu, sepse kam dëshirë të jetoj në Gjermani. Më pëlqen Gjermania. Ka qenë ëndrra ime", ka pohuar Oku.

Pas kualifikimit si mekanik pajisjesh, Adriani ka punuar si instalues e mirëmbajtës për sistemet e ngrohjes.

Alberto Coronado, koordinator i projektit të Qendrës së Mirëseardhjes, përpiqet që punëtorëve si Adriani t'ia lehtësojë ardhjen në Gjermani. "Kur vjen në një vend tjetër në fillim çdo gjë është e re. Ne jemi këtu për t'ua lehtësuar këtyre punëtorëve fillimin", ka theksuar Coronado.

Coronado shikon me vëmendje CV-në e punës së Okut. "Këtu duhet të shkruash, që ke punuar si elektrikist në këtë firmë", e këshillon ai Adrianin.

Dy kompani në rajonin e Hessenit i bien ndër mend koordinatorit, të cilat mund të shfaqin interes për Adrian Okun. Nevoja për instalues është e madhe në Gjermani. "Tani duhet ta dërgojmë njëherë CV-në tënde. Shanset duken të mira", ka deklaruar



Coronado.

Pengesa më e madhe për Okun mbetet gjuha gjermane. Ai kërkon gjatë derisa të gjejë fjalët e duhura në gjermanisht dhe mendohet mirë para se të thotë diçka. "Gjermanishtja është vërtet e vështirë, por edhe e bukur", ka theksuar Oku.

Në studimin e Organizatës për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin (OECD), katër nga dhjetë të anketuar përmendin gjermanishten si pengesë që të vijnë të punojnë në Gjermani.

Në Gjermani flitet kryesisht gjermanisht në reparte fabrikash, laboratorë apo dhoma conference. Por ajo që duket e vetëkuptueshme gjermanëve, a mos është një faktor që e dobëson Gjermaninë në konkurrencën

për tërheqjen e fuqisë punëtore?

Chris Pyak, konsulent i aplikantëve për një vend pune në Gjermani, thotë "po". Atë që Alberto Coronado bën në landin e Hessenit, ai e bën si ndërmarrës në Dysseldorf.

25 mijë vetë e kanë abonuar revistën e tij online. Pengesat kryesore për fuqinë punëtore ndërkombëtare që të vijë në Gjermani nuk janë rregullat e imigrimit apo njohja e diplomave, sipas tij. "Fakti që në të gjithë Gjermaninë vetëm 4 për qind e të gjitha vendeve të punës janë të shkrura në anglisht", ka theksuar Pyak.

Kjo në një kohë që shumë punë që kërkohen sot mund të kryhen edhe me njohjen e gjuhës angleze. Një specialist

softuerësh për shembull.

Në mijëra kompani në të gjithë botën kjo është e vetëkuptueshme.

Pyak kërkon një kulturë të re kundrejt imigrantëve. "Nëse duam që të vijnë më të mirët te ne, duhet që të përpiqemi për ta. Ndryshe vijnë vetëm ata që nuk kanë zgjidhje tjetër", thekson ai.

Edhe Jessica James, 31-vjeç, me bachelor të përfunduar në ekonomi, 9 vjet punë në banka të ndryshme, ndoshta do të ishte një fuqi e duhur punëtore për Gjermaninë. Ajo jeton në Islambad, Pakistan dhe si arsye të vetme për largimin nga vendi përmend fenë. "Jam e krishterë në një vend mysliman", ka thënë James.

Por Gjermania nuk është një

vend ku Jessica do të vinte të punonte. Për të punuar aty duhet gjermanishtja dhe është e vështirë të mësohet si gjuhë. "Përveç kësaj Gjermania është shumë e rreptë në dhënien e vizës, po ashtu kam dëgjuar se gjermanët janë të ashpër ndaj njerëzve me ngjyrë, në tërësi kundrejt emigrantëve", shton ajo.

Bankierja e re kërkon të emigrojë në Holandë.

Njerëzit të ftohtë, gjuha e vështirë, viza merret me vështirësi? Tingëllon sikur Gjermania nuk është aq tërheqëse për punëtorët e huaj.

Thomas Liebig, ekspert për OECD, e kundërshton këtë. Ai shikon një potencial të madh të forcave shumë të kualifikuara që të vijnë në Gjermani. Në studimet e fundit dhe sondazhet Gjermania është vlerësuar mjaft pozitivisht, megjithëse ndodhet pas Australisë dhe ShBA-së.

Liebig dhe kolegët e tij kanë zhvilluar anketime me rreth 30 mijë vetë që kanë vizituar faqen e internetit të qeverisë gjermane për fuqinë e kualifikuar nga jashtë, pra ata që kanë interes për një punë në Gjermani. Pengesa më e madhe që ata kanë është si të kërkojnë konkretisht një punë në Gjermani, ose sepse nuk i lexojnë dot afishimet online për punë, ose se nuk kanë ndihmë për aplikimet.

Shumica përfytyrojnë të vijnë në Gjermani për shkak të shanseve të mira për punë dhe karrierë. Dhe dy nga tre të anketuarit përmendin cilësinë e lartë të jetesës në Gjermani si arsye për interesin e tyre. /DW/

## Hajdari thotë Kosova ka përparësi të shumta për investime të huaja

**PRISHTINË, 14 DHJETOR** - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Rozeta Hajdari, ka deklaruar se Kosova ka përparësi të shumta për investime të huaja.

Hajdari në konferencën vjetore mbi zhvillimet më të fundit në promovimin dhe tërheqjen e investimeve në Kosovë tha se Kosova synon më shumë investime, eksporte dhe punësim, teksa shtoi se vendi ynë ka potencial të ndërmarrësisë.

Gjatë periudhës janar- shtator 2022 investimet e huaja kanë shënuar vlerën në 566.9 milionë euro apo, krahasuar me vitin e kaluar të periudhës së njëjtë, ka një rritje prej 43.6 përqindësh të investimeve të huaja.

Pavarësisht prej sfidave, Kosova ka tërhequr një numër investitorësh të rëndësishëm, duke përfshirë disa firma ndërkombëtare, megjithëse ka

mjaft potencial të pashfrytëzuar. Në këtë ngjarje u tha se Kosova ka bërë përparim të vazhdueshëm për krijimin e një ekonomie tregu moderne dhe miqësore, duke ofruar mundësi të mëdha investimi, duke ruajtur rritjen ekonomike dhe stabilitetin rajonal. Sipas KIESA-s, ekonomia e Kosovës në vitet e fundit ka shënuar një normë pozitive të rritjes ekonomike përkundër sfidave që paraqesin luhajtjet në ekonominë globale, veçanërisht në atë evropiane.

Po ashtu, u tha se në këtë aspekt Kosova ka shënuar një rritje të konsiderueshme të investimeve gjatë vitit 2021, duke arritur vlerën prej 420.7 milionë eurosh. Kjo ngjarje mblodhi të gjithë aktorët relevantë dhe një spektër të gjerë të ndërmarrjeve dhe bizneseve kosovare. Objektivi i përgjithshëm është ta nxisë rritjen e IHD-ve dhe eksporteve të Kosovës.





# Ushtria Çlirimtare e Kosovës në këngët popullore



**Prof. dr. Adem  
ZEJNULLAHU**

## Hyrje

Kënga historike është ndër krijimet poetike gojore më të përhapura në poezinë popullore e cila bashkëjetoj dhe u transmetua me shekuj në mbarë hapësirën shqiptare. Kjo këngë u dha jehonë të fuqishme, me kohë, të gjitha kërkesave, aspiratave dhe idealeve të popullit tonë për liri e pavarësi nga sunduesit e huaj gjatë rrjedhave historike. Mesazhi i saj, në një mënyrë, mobilizoi dhe forcoi shpirtin e shqiptarëve për luftë dhe mbrojtje të trojeve të veta. Ky krijim gojor poetik u bë kronikë besnike e të gjitha ngjarjeve të rëndësishme që ndodhen në hapësirën shqiptare dhe më gjerë, duke i kënduar të gjitha ngjarjet dhe personazhet më të rëndësishme që ndërlidhen me to. Identiteti kombëtar në asnjë lloj të poezisë popullore nuk shprehet më mirë dhe më fuqishëm sesa në epikën popullore historike.

Periudha e viteve 1998-1999 në këngët historike pasqyrohet në mënyrë të gjithanshme, me të gjitha dimensionet e saj, realiteti jetësor e historik, në kohë e hapësirë të caktuar. Asnjë lloj i poezisë sonë popullore nuk e pati fatin e saj që të zhvillohet, të përhapet, të interpretohet dhe të censurohet si kjo. Kjo këngë në viset e pushtuara ishte e ndaluar, madje e ndëshkuar, por ajo u

krijua dhe u këndua pandalshëm nga brezat. Si këngë e ndaluar në vazhdimësi ka pasqyruar vuajtjet, përpjekjet, qëndresën dhe luftërat e shqiptarëve kundër pushtuesve të huaj.

Lufta dhe sakrifica e UÇK-së, epokë e re në historinë kombëtare Kapitënë e veçantë në zhvillimet e historisë sonë më të re paraqet lufta e armatosur e Adem Jasharit, familjes së tij dhe UÇK-së kundër okupatorit serb, që shënoi faqet më të ndritshme të historisë së kombit tonë gjatë këtij shekulli. Ngjarja e Prekazit në shkurtin e vitit 1998, me ç'rast Adem Jashari me familjen e tij dhe me shumë të tjerë qëndroi, luftoi dhe sakrifikoi një numër të madh të anëtarëve të familjes, është e veçantë në historikun e zhvillimit të luftërave të ndryshme në botë, kur një shtet me tërë arsenalin e tij ushtarak vërsulet mbi një familje me pak armatim, por me një guxim dhe vendosmëri të pashoqe që të luftojë dhe të sakrifikojë në emër të besës, nderit dhe lirisë së vendit.

Kjo ngjarje me protagonistin e saj, komandantin e UÇK-së, Adem Jashari, te shqiptarët, sidomos në Kosovë, jehoi si shenjë zgjimi, mobilizim për luftë, për çlirim dhe pavarësimin Kosovës njëherë e përgjithmonë, ndaj ngjarjen e Prekazit e kanë temë trajtimi, duke e kënduar flijimin e familjes Jashari, si akt i veçantë trimërie dhe madhështie, sakrificë sublime kombëtare për çlirimin e Kosovës nga pushtuesi serb. Emri i Adem Jasharit, lufta e tij dhe e UÇK-së, jehoi fuqishëm në gjithë hapësirat shqiptare dhe më gjerë.

Ajo frymëzoi rapsodët popullore, poetët, shkrimtarët, piktorët, skulptorët dhe të tjerët për të krijuar vepra me vlera të mëdha përmbajtësore dhe artistike. Pra, Prekazi e tronditi thellë regjimin e egër serb dhe e zgjoi nga hutimi faktorin e jashtëm ndërkombëtar, duke e ndërgjegjësuar për pozitën e vështirë të shqiptarëve në Kosovë, veçmas shtetet e mëdha të Evropës, të cilat ishin përgjegjëse, sepse në të kaluarën disa herë e dëmtoan shumë rëndë çështjen shqiptare.

## Heroizmi i luftëtarëve të lirisë në këndimin epik

Vepra heroike e Adem Jasharit frymëzoi dhe mobilizoi shqiptarët pa marrë parasysh moshën e gjininë. Edhe fëmijët këndonin këngë nëpër sheshe të ndryshme për të, po edhe bashkëluftëtarët e tij. Poetët shkruan vjersha dhe rapsodët kënduan këngë për aktin e tij madhor. Kudo e në çdo vend dëgjoheshin këngë për Adem Jasharin. Kjo përditshmëri e bënte të gjallë figurën e tij, ngjallte shpresën dhe guximin e popullit për qëndresë dhe luftë kundër armikut. Sakrifica e tij në altarin e lirisë ishte kushtim, guxim, shpresë e fuqi, mobilizim për luftëtarët e lirisë dhe për mbarë popullin tonë. Këtë veprim heroik të tij, kënga popullore e paraqet në këtë mënyrë:

N'ball të trimave të vatanit,  
Komandant Adem Jashari,  
Zemërmadhi pushkën n'sy,  
Bini trima për liri!<sup>1</sup>

Drenica, Prekazi i bëhet këngëtarit mjet poetizimi. Ajo, në një anë, kthehet në një personazh me ndjeshmëri që mishërohet me atmosferën e luftës për liri dhe, në anën tjetër, në atë të barbarisë së egër të armikut që djeg, shkatërron e shkretot para vetes çdo gjë që është shqiptare. Në këtë shkretnim, sipas këngëtarit, ditët nuk janë siç duhet të jenë të bardha, ato janë të zymta, ndaj shprehet figurativisht, edhe stina e pranverës ndal hapin nga çmenduria serbomadhe:

Ç'janë këto gjamë si herave tjera?  
N'atë Drenicë, o na u ndal  
Pranvera!  
Janë shembë kullat, janë djegë  
livadhe,  
Ka dalë serbi e po na çelë varre!<sup>3</sup>

Sakrifica e Adem Jasharit me familjen e tij u dha zemër shqiptarëve që të organizohen, mobilizohen, të marrin guxim për luftë të përgjithshme kundër armikut për çlirim dhe pavarësim nga robëria serbe. Në këtë periudhë të vështirë luftime për çdo ditë e më tepër rritej numri i luftëtarëve të lirisë. Këtë masivizim dhe marshim atdhedashës, vargjet e këngës e paraqesin në këtë mënyrë:

Vjen Buroja, vjen Aqareva,  
Mbushën malet plot Adema.<sup>6</sup>

Dimension i veçantë i këtyre krijimeve poetike gojore është strategjia dhe angazhimi i udhëheqësve – komandantëve të UÇK-së, në ballafaqim me

armikun shumë më të fuqishëm, planifikimi, organizimi dhe realizimi i aksioneve luftarake kundër tij. Ata, për ta ngritur moralin luftarake tek ushtarët e tyre, vetë prinin të parët në fushëbetjeja, duke dhënë shembull se si luftohet e vdiset për atdhe.

Rapsodi popullore në këngën e re historike figurën e shquar të Adem Jasharit, që u martirizua me familjen e tij në luftë kundër okupatorit serb më 1998, e përshkruan sikurse heronjtë e traditës sonë, duke e cilësuar heroizmin e tij të pashoqe:

Lumja kulla, o ka ka mrena,  
Oh, ka Ademin me shtatë  
zemra.<sup>11</sup>

Në këtë drejtim duhet thënë se toposet e këtyre i hasim dendur në shumë këngë të periudhave të ndryshme, në të cilat në mënyrë poetike i skalisin figurat e heronjve shqiptarë. Këta luftëtarë nuk kanë frikë nga vdekja, sepse janë më të fortë sesa kullat dhe armët-topatë armikut. Ata janë të palëkundur në qëndrimet dhe në përcaktimin e tyre për sakrificë sublime, për t'i përmbushur idealet e tyre. Dimension i veçantë i këtyre krijimeve poetike gojore është strategjia dhe angazhimi i udhëheqësve- komandantëve të UÇK-së, të cilët kishin barrë të rëndë përgjegjësie si për furnizimin me armë, planifikimin e aksioneve luftarake kundër armikut që ishte shumë më i fuqishëm si në ushtarë ashtu dhe në armatim. Ata për ta ngritur moralin luftarake tek ushtarët e tyre,



vetë prinin në beteja e luftëra të ndryshme, duke u dhënë shembull se si luftohet e vdiqet për atdhe:

Ku më ashpër ishte beteja  
Aty gjendet Fehmiu e Xheva,  
N'çdo aksion e n'çdo përpjekje  
S'u përkulen deri në vdekje!

### Kosharja simbol i ngadhënjimit të UÇK-së mbi forcat kundërshtare

Në kuadrin e këngëve të reja historike, një numër sosh këndojnë për angazhimin e luftëtarëve shqiptarë për thyerjen e kufirit Kosovë-Shqipëri, i cili, në saje të sakrificës së madhe që treguan luftëtarët nga të gjitha viset e ndryshme shqiptare dhe diaspora, u realizua me sukses, por dhe një numër i madh i tyre ranë në altarin e lirisë për të mos vdekur kurrë.

Kushtrim lshon toka shiptare:

Luftë e madhe u ba n' Koshare!  
I prin luft's kryetrimi,  
Shqiponjë malesh komandant  
Agimi.

Përpjekjet dhe lufta e pandërprerë e popullit të Kosovës gjatë periudhës së viteve 1998-1999 në fushëbetejë bëri kthesë të madhe në jetën tonë, në mendimet, veprimet dhe në vizionin për ardhmëri. Kjo distancë kohore është e mbushur përplot ngjarje të dhembshme e krenare për popullin shqiptar që këndohen, përjetësohen dhe interpretohen

nga rapsodët. Në këngë trajtohen në mënyrë të fuqishme vendosmëria, sakrificat e individëve dhe të përbashkëtat për çlirim dhe pavarësi.

Po ta vështrime këngën historike nga pikëvështrimi i brendshëm del në pah e dhëna se struktura e këtij krijimi artistik gjatë dhjetëvjetëshave të fundit shquhet për një shtresim pak a shumë të ri kronologjik-historik, që thekson më tepër argumentin historik me disa karakteristika të ndërtimit kompozicional.

Në vazhdimësinë e zhvillimit të strukturës kompozicionale të këngës së re historike hetohet theksimi i faktografisë historike me shprehësi poetike që funksionalizon rëndësinë e ngjarjeve dhe të heroit. Ndërkaq, formulat, klishtë, hyrjet, përfundimet, përsëritjet dhe përshkrimet pothuajse janë gati strukturë e pandryshueshme.

Në këngën historike të kësaj periudhe hyrja paraqitet me shumë detaje të stërholluara, duke dhënë informacione të hollësishme lidhur me ngjarjen dhe personazhet. Kjo del si rezultat i rapsodëve të arsimuar, të cilët kanë njohuri për historinë, andaj aspektin historik e konsiderojnë si lëndë parësore, kurse përbërësit artistikë i kanë lënë të dorës së dytë. Në këto krijime mbizotëron vetëdijesimi i heroit i cili di pse sakrifkohet, di ta shprehë idealin kombëtar, di e do ta shprehë dashurinë për atdheun, urrejtjen kundër okupatorit dhe, si të tilla, u përngajnë hiperbolizimeve kur

forcat kundërshtare janë të mëdha, ndërsa përballë u rri një luftëtar që nuk e ka drojë vdekjen:

Krisi pushka, gjemoi topi,  
Luftë po bën Shaip Pacolli.  
Ushtrisë s' shkaut para i ka dalë,  
Nuk ka kush trimin me ndalë!1

Kushtimisht struktura e këngës historike varet nga zhvillimet e reja historike, andaj ky krijim poetik popullor nuk i rri besnik modelit tradicional të të kënduarit.

Në këngët që u krijuan kohët e fundit sikurse janë ato për luftërat e UÇK-së në strukturën e tyre bie në sy përshkrimi më i madh i aksioneve luftarake kundër pushtuesit. Kështu, në një numër këngësh, informacioni për kohën zë vend të rëndësishëm.

Në këngën historike dhe në evoluimin e saj, gjatë dhjetëvjetëshave të fundit, përbërës kryesor në strukturën e saj është heroi i sakrificës, pra luftëtari i flijuar për atdhe. Akti sakrifkues për këngëtarin bëhet obligim për ngritje në shkallë të pavdekësisë:

O, krisi pushka si vetima,  
O ra dëshmor, more, Milazim  
Keqina!  
Lum ksi djemsh që i pat vatani,  
O, Xhevat Sylja prej Sllapushani.6

Aktet e sakrificës dhe të heroizmit që paraqiten në këngët e reja të periudhës së fundit, synojnë t'i pavdekësojnë heronjtë. Këto pamje janë të ngjashme me ato të periudhave të mëhershme në

shumë aspekte kompozicionale, sepse janë prodhim i traditës së këndimit.

Në këtë cikël këngësh shquhen ato që këndojnë për protagonistët e dalluar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në to përshkruhet lufta dhe aksionet e luftëtarëve të UÇK-së kundër forcave serbo-malazeze, si ajo e Adem Jasharit, Zahir Pajazitit, Agim Ramadanit, Luan Haradinit, Fehmi e Xhevë Lladrovci e shumë të tjerëve.

Këngët e reja historike të viteve 1998-'99, po të shikohen nga pikëvështrimi i jashtëm dhe i brendshëm, del në pah e dhëna se strukturën e këtyre krijimeve e karakterizon një shtresim i ri kronologjik-historik-informativ që ka për qëllim t'i paraqesë në radhë të parë lexuesit të botës argumentin historik me disa karakteristika të ndërtimit kompozicional. Ato pasqyrojnë hollësisht në mënyrë të vazhdueshme vuajtjet, qëndresën dhe sakrificën e popullit shqiptar nën sundimin e huaj, duke u munduar që ta ruajnë identitetin kombëtar, në raport me dhunën që ushtron shteti okupues. Këngët e tilla të krijuara e të interpretuara gjatë robërisë së Kosovës, si dhe ato gjatë luftës së fundit të Kosovës, kur UÇK-ja e përkrahur nga populli dhe NATO, e çliroi Kosovën, kishin për mision kryesor mobilizimin dhe forcimin e shpirtit të shqiptarëve për luftë dhe mbrojtje të trojeve të veta.

### Fjalë përmbyllëse

Në fund do thënë se këngët që i kushtohen Adem Jasharit, familjes

së tij, si dhe luftëtarëve të tjerë nga rapsodët e ndryshëm, janë krijime të njerëzve të arsimuar dhe të gjitha e atmosferës së luftës, pa depërtime në botën e brendshme të personazheve siç ngjet në këngët e periudhave të mëhershme. Por, në përgjithësi, rapsodët, cilët do qofshin, janë larguar traditës së këndimit me përjashtim kur marrin nga këngët historike ndonjë pamje si pohim që u duket se tingëllon fort. Me rëndësi është se u këndua për luftën, heroizmin dhe sakrificën e luftëtarëve tanë për Çlirim dhe pavarësim të Kosovës. Kështu, këngët e Arif Vladit, Leonora Jakupit, Ilir Shaqirit, Muharrem Gashit, Shaban Shishmanit, Tahir e Hashim Shalës, vëllezërve Hertica etj., paraqesin një dëshmi dhe vlerë të veçantë në folkloristikën tonë. Në këngët e tyre, në përgjithësi, madhërohet figurën e Adem Jasharit dhe e luftëtarëve të tjerë, duke i ngritur në përmendore lirie, që rrezatojnë atdhedashuri të përmasave të mëdha në kohë e hapësirë gjithëshqiptare për brezat në vijim.

1 Muharrem Gashi, Këngë popullore II, Prishtinë, 2017. f. 302.

3 Po aty.

6 Po aty.

11 Arkivi i Institutit Albanologjik i Prishtinës, dosja e Nebi Balës. (Kanga për Adem Jasharin).

1 Arkivi i Institutit Albanologjik, dosja e Nebi Balës.

6 Arkivi i Institutit Albanologjik i Prishtinës, dosja e Nebi Balës. (Kënga e Dëshmorëve të Pashtrikut).

# Organizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

Prof. ass. dr. Skender ZHITIA

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, organizatë politiko-ushtarake, zë një vend me rëndësi të veçantë në kuadër të historisë bashkëkohore të popullit shqiptar në dhjetëvjetëshin e fundit të shek. XX. Ushtria Çlirimtare e Kosovës, e cila kishte tejkaluar kufijtë rajonalë të territorit të brendshëm të Kosovës, ka një zanafillë në përpjekjet e vazhdueshme të popullit shqiptar për liri, e cila ndërlihet me gjendjen e përgjithshme shoqërore, ekonomike, politike e, mbi të gjitha, në ngritjen e vetëdijes kombëtare. Duke mos mohuar asnjë nga përpjekjet e mëhershme për çlirim, pas riorganizimeve të lëvizjeve të fshehta kombëtare, në fund të viteve tetëdhjetë të shek. XX shtohen veprimet e organizuara ushtarake, të cilat mund të themi se janë zanafilla apo parahistoria e UÇK-së.[1] Referuar burimeve të ndryshme të kohës në fillim të organizimit të UÇK-së, janë disa vendime të mbledhjeve të fshehta të atdhetarëve, bartësve të organizimit të fshehtë të Lëvizjes Kombëtare si: në Prapashticë, në Ujmir e në Kizhnarekë gjatë vitit 1991, në Kollare e Prishtinë gjatë vitit 1993, të cilat quan deri te formimi i krahut ushtarak për çlirimin e Kosovës dhe viseve shqiptare në Jugosllavi.[2] Së këndejmi, jetësimi i këtij segmenti të veprimtarisë së saj pasoi me formimin e strukturave ushtarake dhe organeve drejtuese, fillimisht të Shtabit Qendror të UÇK-së në vitin 1994 dhe Shtabit Operativ në vitin 1995.[3]

Në fillimet e organizimit, nga 17 nëntori i vitit 1994 e deri më 28 nëntor 1997,[4] UÇK-ja ngjason me organizimet e fshehta politike të shqiptarëve kundër pushtetit jugosllav të viteve '80, që vepronte në mënyrë guerile, sipas taktikës "godit e tërhiq" apo, thënë ndryshe, "kryente sulme të papritura në kohë dhe hapësirë".[5] Ndërkohë, UÇK-ja shpalosi sheshazi para popullit shqiptar dhe opinionit ndërkombëtar synimin dhe misionin mbi luftën e domosdoshme. Misioni i UÇK-së i përcaktuar mbi synimin ishte zhvillimi, drejtimi, koordinimi dhe udhëheqja e të gjitha veprimeve ushtarake në luftën për çlirimin e Kosovës nga forcat pushtuese serbo-jugosllave, mbrojtja dhe mbështetja e popullsisë civile, si dhe angazhimi në proceset politike e diplomatike rreth statusit të ardhshëm politik të Kosovës.[6] UÇK-ja, për ta përmbushur misionin, në zhvillim e sipër ka ngritur një strukturë të organizimit, e cila i ka mundësuar komandimin dhe kontrollin nga njësit taktike deri në nivelin strategjik e politik. UÇK-ja në rrethanat e strukturimit kishte

vështirësi në komandim, komunikim, shtrirje dhe organizim të njëkohshëm në tërë territorin e Kosovës. Por, pavarësisht prej vështirësive, UÇK-ja u bë shembulli organizimit të një guerileje e cila po bënte përpjekje të kalonte në formacione të ushtrive të strukturuar dhe të luftonte për çlirim, duke respektuar konventat ndërkombëtare të luftës.

Si në çdo organizatë ushtarake, edhe në UÇK komandimi dhe kontrolli ishin elemente thelbësore të artit dhe të shkencës së luftës. Komandimi ishte akti autoritar i marrjes së vendimit dhe urdhrat të veprimit luftarak, ndërsa kontrolli ishte akti i mbikëqyrjes së këtij veprimi dhe ndikimi mbi të. Me qëllim të marrjes së këtyre vendimeve, në kuadër të UÇK-së u formuan shtabet, nga Shtabi i Përgjithshëm e deri në nivel batalioni, shtabe të cilat kishin për qëllim ta ndihmonin komandantin që ai të merrte dhe të zbatonte vendime në interes të fitimit të luftës dhe çlirimit të vendit.

Shtabi i Përgjithshëm ishte organi më i përgjegjshëm i UÇK-së në rrafshin organizativ, politik dhe ushtarak. Ai ishte përbërësi i strukturës më të lartë organizative e ushtarake dhe kryente komandën unike në UÇK.[7] Duke pasur parasysh se Shtabi duhej të funksiononte si një trup kompakt, me staf profesionist, i cili njeht detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e tij, UÇK-ja ndërtoi një strukturë të Shtabit të Përgjithshëm, e cila mbajti bashkërendim dhe bashkëpunim si brenda vetes ashtu edhe me shtabet e njësiteve më të ulëta. Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së udhëhoq nga komandanti i UÇK-së, i cili kishte dy zëvendëskomandantë: zëvendëskomandant për operacione dhe zëvendëskomandant për mbështetje,[8] pastaj ishin edhe inspektori gjeneral si dhe shefi i kabinetit të komandantit.[9] Komandanti i UÇK-së autoritetin e tij komandues/kontrollues e ushtronte nëpërmjet delegimit të përgjegjësisë te shefi i Shtabit, që komandonte drejtoritë: Drejtorinë e Personelit, Drejtorinë e Shërbimit Informativ, Drejtorinë Operative, Drejtorinë e Logjistikës, Drejtorinë e Marrëdhënieve Publike dhe të Administratës Civile, Drejtorinë e Komunikimit dhe Ndërlidhjes, Drejtorinë e Financave dhe Ekonomisë, Drejtorinë e Policisë Ushtarake dhe Drejtorinë Politike.[10]

Gjithashtu, me qëllim të krijimit të kushteve për organizim dhe planifikim luftarak, janë ngritur njësitet mbështetëse të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Njësitet mbështetëse apo pranë Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së ishin:



Batalioni Diversant Vëzhgues, Batalioni i Policisë, Kompania e Logjistikës, komandant Idriz Hysenaj; Mjekësia, komandant Fadil Beka, Kompania e Komunikimit, Brigada 60, Fondi "Vendlindja thërret", Trupa Artistike Ushtarake "Hamëz Jashari" dhe Batalioni "Atlantiku" Gani Shehu. Misionin e saj në tërë territorin e vendit UÇK-ja e realizonte nëpërmjet zonave operative. Deri më 18 nëntor të vitit 1998 Kosova ishte një Zonë Ushtarake e UÇK-së, e organizuar në shtatë nënzona operative, të cilat u shndërruan në zona operative, si: Zona Operative e Drenicës, e Pashtrikut, e Dukagjinit, e Shalës, e Llapit, e Nerodimes dhe e Karadakut.[11]

Zona Operative e Drenicës (ZOD) gjeografikisht shtrihej në pjesën qendrore të Kosovës. Ajo kufizohej në veri dhe verilindje me Zonën Operative të Shalës (ZOSH), në lindje me Zonën Operative të Llapit (ZOLL), në juglindje me Zonën Operative të Nerodimes (ZON), në jug me Zonën Operative të Pashtrikut (ZOP), dhe në jugperëndim me Zonën Operative të Dukagjinit (ZODGJ).\*

Zona Operative e Drenicës është nismëtarja dhe kushtrimi i themelimit dhe shtrirjes së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në territorin e përgjegjësisë së ZOD kanë vepruar katër brigada: Brigada 111 "Adem Jashari", Brigada 112 "Arben Haliti", Brigada 113 "Mujë Krasniqi" dhe Brigada 114 "Fehmi Lladrovci".[12] Zona Operative e Pashtrikut gjeografikisht shtrihej nga pjesa qendrore deri në pjesën jugore të Kosovës. Ajo kufizohej në pjesën veriore me Zonën Operative të Drenicës, në veri dhe verilindje me Zonën Operative të Nerodimes, në juglindje dhe jug me Maqedoninë e Veriut, në jugperëndim me Shqipërinë dhe në perëndim me Zonën Operative të Dukagjinit. Në territorin e përgjegjësisë së ZOP-it kanë vepruar pesë brigada: Brigada 121 "Ismet Jashari (Kumanova)", Brigada 122 "Imer Krasniqi", Brigada 123 Brigada 124 "Gani Paçarizi" dhe Brigada 125. Në themelim kanë qenë edhe dy brigada, Brigada 126 dhe Brigada 127/28.[13]

Zona Operative e Dukagjinit (ZODGJ) gjeografikisht shtrihej në pjesën jugperëndimore të Kosovës.

Ajo kufizohej: në pjesën juglindore me Zonën Operative të Pashtrikut (ZOP), në verilindje me Zonën Operative të Drenicës (ZOD), në veri me Zonën Operative të Shalës, në perëndim me ish-Republikën e Malit të Zi dhe Serbinë dhe në jugperëndim me Shqipërinë. Në kuadër të strategjisë së luftës së UÇK-së, në territorin e përgjegjësisë së ZODGJ-së janë themeluar tetë brigada: Brigada 131 "Jusuf Gërvalla", Brigada 132 "Myrtë Zeneli", Brigada 133 "Adrian Krasniqi", Brigada 134 "Bedri Shala", Brigada 135 "Agim Zeneli", Brigada 136 "Rugova", Brigada 137 "Gjakova" dhe Brigada 138 "Agim Ramadani".[14]

Zona Operative e Shalës (ZOSH) gjeografikisht shtrihej në pjesën veriperëndimore të Kosovës. Ajo kufizohej: në verilindje me Zonën Operative të Llapit (ZOLL), në veri dhe veriperëndim me Serbinë dhe Zonën Operative të Dukagjinit (ZODGJ) dhe në jug me Zonën Operative të Drenicës (ZOD). Në kuadër të strategjisë së luftës së UÇK-së, në territorin e përgjegjësisë së ZOSH-së janë themeluar dy brigada: Brigada 141 "Mehë Uka"

dhe Brigada 142.[15] Zona Operative e Llapit (ZOLL) gjeografikisht shtrihet në pjesën verilindore të Kosovës. Ajo kufizohet: në verilindje me Serbinë, në juglindje me Zonën Operative të Karadakut (ZOK), në jug me Zonën Operative të Nerodimes (ZON), në jugperëndim me Zonën Operative të Drenicës (ZOD) dhe në veriperëndim me Zonën Operative të Shalës (ZOSH). Në kuadër të strategjisë së luftës së UÇK-së, në territorin e përgjegjësishë së ZOLL-it ishte planifikuar themelimi i tri brigadave: Brigada 151 "Zahir Pajaziti", Brigada 152 "Shaban Shala" dhe Brigada 153 "Hyzri Talla".[16]

Zona Operative e Nerodimes (ZON) gjeografikisht shtrihet nga pjesa qendrore deri në pjesën juglindore të Kosovës. Ajo kufizohet: në pjesën veriore me Zonën Operative të Llapit (ZOLL), në lindje me Zonën Operative të Karadakut (ZOK), në juglindje dhe jug me Maqedoninë e Veriut, në jugperëndim me Zonën Operative të Pashtrikut (ZOP) dhe në veriperëndim me Zonën Operative të Drenicës (ZOD). Në territorin e përgjegjësishë së ZON-it kanë vepruar tri brigada: Brigada 161 "Ahmet Kaçiku", Brigada 162 "Agim Bajrami" dhe Brigada 163 "Gafurr Loku".[17]

Zona Operative e Karadakut (ZOK) gjeografikisht shtrihet në pjesën lindore të Kosovës. Kufizohet: në pjesën veriperëndimore me Zonën Operative të Llapit (ZOLL), në lindje me Serbinë, në juglindje me Maqedoninë e Veriut, në jugperëndim dhe perëndim me Zonën Operative të Nerodimes. Në territorin e përgjegjësishë së ZOK-ut kanë vepruar tri brigada: Brigada 171 "Kadri Zeka", Brigada 172 "Isa Kastrioti" dhe Brigada 173 "Gursel dhe Bajram Sylejmani".[18]

Për nga strukturimi dhe organizimi në terren, krahasuar me organizimet e tjera ushtarake, zonat operative të UÇK-së kishin një organizim dhe strukturë të përafërt të një divizionit standard ushtarak. Ndarja e përgjegjësishë territoriale të zonave operative ishte në përputhje me ndarjen strategjike të veprimit të UÇK-së, gjithnjë të sinkronizuara dhe në bashkëpunim ndërmjet zonave, në mbështetje dhe në veprime luftarake të përbashkëta.

Zonat operative të UÇK-së organin më të lartë komandues dhe të kontrollit e kishin Shtabin e Zonës, përmes të cilit komandohehin njësitet taktike, siç janë brigadat, ku në territorin e përgjegjësishë së tyre kishin dy deri në tetë brigada.[19] Formimi dhe strukturimi i zonave operative nuk ishte i njëkohshëm, por në përputhje me zhvillimin e luftimeve, në përputhje me strategjinë e organizimit të UÇK-së, në përputhje me zhvillimin dhe ngritjen e nivelit të organizimit në periudha të ndryshme kohore.\*

Brigadat e zonave operative në territorin e përgjegjësishë së veprimit si njësitë taktike, në strukturën e tyre kishin deri në katër batalione, e batalionet përbëheshin nga kompanitë, togjet dhe skuadrat.

Nga maji i vitit 1999 në të gjitha zonat operative të UÇK-së janë themeluar batalionet gardiste, të cilat kishin për detyrë ndërhyrjet e shpejta dhe sulmuese.[20]

Gjatë luftës çlirimtare UÇK-ja ka përdorur dhe ka bartur flamurin identifikues, flamurin kombëtar, flamurin me sfond të kuq, në mes shqiponjën e zezë dykrenare, si dhe ka kënduar himnin ("Himnin e flamurit"). Gjithashtu, në rrugëtimin e UÇK-së e rëndësishme është emblema, e cila u dizajnuar dhe filloi të prodhohet në fillimin e marsit të vitit 1998. Emblema kishte elemente kombëtare dhe luftëtarë e UÇK-së në uniformat e tyre bartnin dy lloj emblemash: atë të kraharorit dhe të kapelës. Ushtarët e UÇK-së, si në rrethana lufte, gjatë trajnimeve, po edhe gjatë jetës në objektet ushtarake, bartnin uniformën e cila ishte uniformë kamuflazh dhe përbëhej nga xhaketa, këmisha, pantallonat, kapela me strehë, bereta dhe çizmet.

Luftëtari (ushtar dhe oficer) i UÇK-së ishte shembull i një personi vigilent, i kujdesshëm dhe besnik, si në detyrën dhe përgjegjësishë para eprorit dhe bashkëluftëtarëve të vet, i gatshëm të sakrifikohej për bashkëluftëtarin dhe për atdheun. Luftëtari i UÇK-së ishte vullnetar, simbol i të gjitha trojeve shqiptare nga jugu e në veri, nga lindja e në perëndim, i të gjitha moshave, gjinive dhe profesioneve, një person i cili gjithçka i kushtonte çlirimit të Kosovës. UÇK-ja, me rekrutimin e luftëtarëve, organizonte trajnime përgatitore, të cilat, në kuadër të planeve dhe programeve, kishin për qëllim përgatitjen psiko-fizike, taktike dhe operative të luftëtarëve.[21]

Pas përfundimit me sukses të këtyre trajnimeve, organizohej betimi i luftëtarit të UÇK-së: "Unë, ushtari i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, betohem se do të luftoj për çlirimin e tokave shqiptare dhe bashkimin e tyre. Do të jem përherë ushtar besnik, luftëtar i denjë i lirisë, vigilent, guximtar dhe i disiplinuar, i gatshëm që në çdo kohë pa kursyer as jetën time të luftoj për t'i mbrojtur interesat e shenjta të atdheut. Nëse shkel këtë betim, le të ndëshkohem me ligjet më të ashpra dhe nëse tradhtoj, qoftë i humbur gjaku im. Betohem, betohem, betohem".[22] Në tekstin e betimit shihen gatishmëria, besnikëria, vigilenca, guximi, disiplina e luftëtarit të UÇK-së për çlirimin e tokave shqiptare dhe bashkimin e tyre, si dhe pranimi i dënimit kapital në rast të mospërbushjes së betimit.

Luftëtarët e UÇK-së në betejat si e Rrezallës, Likoshanit, Prekazit, Glogjanit, Llapushnikut, Jezercit, Rahovecit, Kaçanollit, Llapashticës, Mazhiqit, Oshlanit, Zhegocit, Koshares etj. treguan vlerat mbi të cilat u kalitën dhe u bënë shembull më i mirë se si luftohet dhe si sakrifkohet për atdheun. Ata me heroizmin e pashoq dhe me rëniet e tyre u bënë themel i lirisë dhe i shtetësisë së Kosovës. Gjatë luftës çlirimtare të UÇK-së ranë 2 132



dëshmorë, u plagosën 2 019.[23] UÇK-ja, që nga 4 janari, përmes institucioneve informative si Agjencia Kosovapress dhe Radiostacioni Kosova e lirë, njoftonte opinionin e brendshëm dhe atë të jashtëm për luftën e drejtë çlirimtare, për betejat heroike, rëniet dhe heroizmat e luftëtarëve dhe për strategjinë liridashëse të UÇK-së e cila po shkonte drejt sendërtimit të aspiratës kombëtare. Jakup Krasniqi rreth rolit të këtyre dy institucioneve në atë kohë thoshte: Këto institucione kanë për detyrë e qëllim për t'ujapin zërin meritor pushkëve të lirisë, që me zë e shkrime të njoftojnë opinionin e brendshëm e të jashtëm për luftën e drejtë çlirimtare të popullit dhe ushtrisë së tij, për t'i treguar sukseset e luftës në tërë Kosovën, për të bërë të njohur strategjinë tonë liridashëse. Kjo punë që po nis sot është edhe një dëshmi tjetër se UÇK-ja seriozisht e sinqerisht po lufton për lirinë, pavarësinë e demokracinë e Kosovës, që po shkon drejt sendërtimit të aspiratës sonë kombëtare.[24]

Në pikëpamje historike, ushtarake, politike dhe diplomatike, UÇK-ja ishte projekti më i suksesshëm i kombit shqiptar në shek. XX. Ajo, me luftën e drejtë dhe të domosdoshme kundrejt forcave pushtuese, së bashku me faktorin relevant ndërkombëtar, i dha fund gjenocidit mbi popullin shqiptar në Kosovë. Prandaj, UÇK-ja përfaqëson një epokë të rëndësishme historike për popullin shqiptar në Kosovë dhe marrëdhëniet ballkanike, evropiane e botërore. Lufta e saj zgjidhi përfundimisht statusin politik e juridik të Kosovës.

[1] Hashim Thaçi, programi dokumentar i RTK-së kushtuar dëshmorit Afrim Zhitia, viti 2002; Shkëndijata e një lufte të armatosur i hasim gjatë gjithë shek. XX. Duke mos mohuar asnjë nga këto shkëndija që u bartën gjithandëj Kosovës, do t'i veçoja: Luftimet e

Çetës së Llapit, dhe rënien heroike të Ali Ajetit, në Labarion (Shtedim) të Besianës (Podujevës, më 30 maj 1989); Rënia heroike e Afrim Zhitisë dhe Fahri Fazliut më 2 nëntor 1989 në Kodër të Diellit në Prishtinë; sulmi i forcave pushtuese serbe në familjen Jashari më 30 dhjetor 1991; si dhe lufta dhe rënia heroike e Hasan Ramadanit nga Albaniku (Shajkovci) i Besianës (Podujevës) më 7 gusht 1994.

[2] Skender Zhitia, Ushtria Çlirimtare e Kosovës-Zona Operative e Llapit, Prograf, Prishtinë, 2008, f.49, 50 (Më tej: Zhitia, UÇK-ZOLL). Më 2 shkurt të vitit 1991 në fshatin Prapashticë (në shtëpinë e Bajram Prapashticës), komuna e Prishtinës, është organizuar Konferenca e Dytë e LPRK-së. Kjo ka qenë konferencë e jashtëzakonshme, pas gjendjes së krijuar, kur në udhëheqjen e Organizatës ishin krijuar tri vende të lira. Është zgjedhur Komiteti Drejtues prej pesë vetave. Në komitet janë zgjedhur: Xhavit Haziri, Ramadan Avdiu, Halil Selimi, Ismet Sylejmani dhe Halit Krasniqi. Është aprovuar platforma e punës. Është marrë vendim që të vazhdohet veprimtaria në formën klandestine dhe aty ku ka mundësi të kombinohet me praktikën legale të veprimit. Është vendosur që menjëherë komiteti ta fillojë punën e përgatitjes së Mbledhjes së Përgjithshme të LPRK-së dhe Këshilli Drejtues i LPRK-së të formohet brenda vendit. Më 4 tetor të vitit 1991 në Ujëmirë të Klinës është mbajtur Mbledhja e Tretë e Përgjithshme e LPRK-së. Nga kjo mbledhje është zgjedhur Këshilli Drejtues i përbërë nga 17 anëtarë. Më 11 tetor 1991 në Ndreka (Kizharekë), në shtëpinë e Azem Sylës, mbahet mbledhja e Këshillit Drejtues, i cili zgjedh kryesinë. Gani Sylja, kryetar, Xhavit Haziri, Ramadan Avdiu, Halil Selimi, Guximtar Labenishiti nga Struga dhe Hidajete Krasniqi, anëtarë të kryesisë. Më 25 dhjetor arrestohet Halil Selimi. Pas kësaj ngjarjeje një

pjesë e udhëheqjes kalon në ilegalitet të thellë (Xhavit Haziri, Azem Sylja, Ramadan Avdiu) në prill 1993. Në Kollare të Kërçovës mbahet mbledhja konsultative e LPRK-së, ku marrin pjesë: Gafurr Elshani, Ahmet Haxhiu, Ali Ahmeti, Adnan Asllani, Hashim Thaçi, Azem Sylja, Behajdin Hallaçi, Adem Grabovci, Halil Selimi, Xhavit Haziri, Ramadan Avdiu, Hidajete Krasniqi, Binak Berisha, Hysen Gega, Ramadan Pllana, Ilaz Kadolli, Fadil Bajrami, Musa Demiri, Behxhet Luzha, Fatmir Brajshori etj. Në këtë takim u lëshuan konkluzionet, sipas të cilave, LPRK mbështet të gjitha aksionet e armatosura kundër pushtuesve. Gjithashtu, u krijua Grupi i Organizimit dhe Riorganizimit (GOR), i cili u ngarkua me detyrë për ta organizuar Mbledhjen IV të Përgjithshme të LPRK-së. Grupin e përbënin: Ramadan Avdiu, kryetar i grupit, anëtar Hashim Thaçi, Adnan Asllani, Bilal Sherifi dhe një person nga Maqedonia. Grupi i Organizimit të Mbledhjes IV të Përgjithshme të LPRK-së, pas përgatitjeve të duhura, më 26-27 korrik 1993, në Kodër të Trimave në Prishtinë, në shtëpinë e Fatmir Brajshorit, organizon Mbledhjen IV të Përgjithshme të LPRK-së.[2] Në këtë mbledhje marrin pjesë: Xhavit Haziri, Ramadan Avdiu, Bilal Sherifi, Mehmet Bislimi, Halil Selimi, Adnan Asllani, Xhemal Rudi, Guximtar Labenishiti, Ejup Thaçi, Mustafë Krasniqi, Isa Krasniqi, Xheladin Gashi, Fatmir Brajshori, si dhe delegatët nga Dega Jashtë Vendit: Fazli Veliu, Emrush Xhemajli, Beqir Beqa, Sabri Kijçmari, Bilal Sherifi e të tjerë drejtues dhe delegatë nga terreni. Mbledhjen e ka udhëhequr kryesia e punës në përbërje: Fazli Veliu, Xhavit Haziri dhe Adnan Asllani. Mbledhjen e kishte shpallur të hapur delegati më i vjetër Fazli Veliu, ndërsa procesverbalin e kishte mbajtur Emrush Xhemajli. Në mbledhje bëhen ndryshime programore e statutare, si dhe

ndërrohet emri nga LPRK në LPK (Lëvizja Popullore e Kosovës). Në program tekstualisht aprovohet si mjet i arritjes së qëllimit lufta e armatosur për çlirimin e Kosovës dhe viseve shqiptare në ish-Jugosllavi. Vendime të tjera ishin: Aprovimi i rezolutës, sipas së cilës, lufta e armatosur duhej të ishte prioritet i veprimeve të LPRK-së dhe formimi i krahut ushtarak. Në krahun ushtarak u caktuan: Azem Sylja e Xhavit Haliti në Kosovë, ndërsa Xhavit Haliti u autorizua që të merrej me procesin e organizimit ushtarak në Shqipëri dhe në diasporë. Për të jetësuar këto vendime u organizuan takime me drejtuesit brenda dhe jashtë vendit. Gjatë takimeve në Prishtinë (Nait Hasani takohet me Sokol Bashotën), Tetovë, Tiranë (Naiti takohet me Azem Sylën) e Zvicër (Azem Sylja takohet me Xhavit Halitin dhe Ali Ahmetin), merret vendimi përfundimtar për formimin e strukturave ushtarake dhe organeve drejtuese të saj (Shtabi Qendror dhe ai Operativ). Vendim i rëndësishëm për luftën në vazhdim ishte formimi i Fondit "Vendlindja thërret" në vitin 1993. Kryetar i fondit caktohet Jashar Salihu.

[3] Xhavit Haliti, int., gaz. Zëri, f. 42; Nait Hasani: "Të vdesim si burrat dhe, kur të shtien në ne, do të thërrasim: Rroftë pavarësia e Kosovës!", Zëri, Prishtinë, shtator-tetor 2002, int. është botuar në Libri i Lirisë, Prishtinë, Zëri, 2003, f. 145; Rexhep Selimi në gazetën javore Zëri, dt. 9 tetor 1999, thotë: "Azem Sylja ka qenë komandant i UÇK-së që nga fillimi e deri në ndërrimet që u bënë gjatë Konferencës së Rambouilletit". Shtabi Qendror i UÇK-së themelohet në vitin 1994. Anëtarët e parë të shtabit ishin: Azem Sylja, Xhavit Haliti, Ali Ahmeti, Jashar Salihu, Nait Hasani, Xheladin Gashi e Sokol Bashota. Komandant i UÇK-së emërohet Azem Sylja, kurse shef i Shtabit Operativ (brenda në Kosovë) emërohet Nait Hasani. Në Prishtinë, në mars-prill të vitit 1995, është krijuar Shtabi Operativ në nivel të Kosovës (plotësimi i tij është bërë në dhjetor të vitit). Anëtarët të Shtabit Operativ ishin: Nait Hasani, Rexhep Selimi, Zahir Pajaziti, Lahi Brahimaj, Sokol Bashota, Bislim Zogaj. Sipas Nait Hasanit, Adem Jashari ishte anëtar i Shtabit Operativ, por për shkaqe objektive nuk merrte pjesë në takimet e Shtabit Operativ. Nait Hasani shkonte e kontaktonte me të në Prekaz. Shtabi Operativ selinë e kishte në Prishtinë, por kishte edhe shumë baza të tjera ndihmëse si në: Divjakë, Sankofc e Kamaran.

[4] Emrush Xhemaili, 20 vjet veprimtari, Prishtinë, 2002, faqja e internetit, Lpk-Kosova.com, data e leximit 18.06.2006. Në mbledhjen e Kryesisë së LPK-së, mbajtur (në qytetin Aarau) në Zvicër, më 17 nëntor 1994 u vendos të lëshohej komunikata e parë ushtarake (komunikata ishte vendosur të mbajë nr. 11), si dhe duke pasur parasysh propozimet e grupimeve ushtarake në terren, u mor vendim

që organizmi i ri ushtarak të quhet "Ushtria Çlirimtare e Kosovës"; Xhavit Haliti: Si e bëmë UÇK-në, Zëri, Prishtinë, shkurt 2001-janar 2003. Int. është botuar në Libri i Lirisë, Prishtinë, Zëri, 2003, f. 42. Në këtë mbledhje të pranishëm ishin Fazli Veliu, Gafurr Elshani, Emrush Xhemajli, Xhavit Haliti, Ali Ahmeti, të cilët e kanë dizajnuar dhe formën e emërtimit të UÇK-së. Nga kjo kohë njësitë guerile që kanë ekzistuar në Kosovë janë shkrirë e përmbledhur me një emër, organizim, komandë dhe një Shtab Qendror (të Përgjithshëm) të vetëm dhe me një Shtab Operativ, që kanë organizuar dhe drejtuar Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës

[5] Jacques Baudouin, Lindja e një demokracie, Hashim Thaçi dhe rruga drejt Kosovës së pavarur (1998-2008), Buzuku, Prishtinë, f. 80.

[6] Deklaratë politike nr. 2 e Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, dt. 29 prill 1998; Gazeta Koha ditore, "Intervistë ekskluzive me zëdhënësin e UÇK-së, Jakup Krasniqi (1)", e shtunë, 11.07.1998; Rexhep Selimi, "Përirimi i UÇK-së si i vetmi mjet-forcë për fitimin e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës", kumtesë e lexuar në tryezën shkencore "Yjet e përflakur në themelet e UÇK-së", organizuar nga ish-Zona e Pestë e TMK-së, më 31 janar 2001; Jakup Krasniqi, "UÇK-ja, një dhe e pandarë", kumtesë e lexuar në tryezën shkencore "Yjet e përflakur në themelet e UÇK-së", organizuar nga ish-Zona e Pestë e TMK-së, më 31 janar 2001.

[7] Jakup Krasniqi, fejtton politik, Rambuje, një vit pas (10), Zëri, e mërkurë, 16 shkurt 2000.

[8] <https://video.girafa.com/indoks>, intervistë me Jakup Krasniqin, zëdhënësi i UÇK-së, qasur më 15 janar 2019.

[9] Jakup Krasniqi, Kthesa e madhe, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Buzuku, Prishtinë, 2006, f. 135. (Më tej: Krasniqi, Kthesa e madhe); Avdi Raci, bisedë me autorin, Në të dhënat e Departamentit për Marrëdhënie Ushtarake-Civile të SHPTMK-së, viti 2008, e gjejmë si Shërbimi Juridik Ushtarak.

[10] Sipas Jakup Krasniqit, "SHP i UÇK-së që nga fillimi kishte Komandantin e Përgjithshëm, zëvendëskomandantin, shefin e Shtabit, inspektorin gjeneral dhe kryeshefat e disa drejtorive. Pas eskalimit të luftimeve, nga marsi i vitit 1998, konform situatës, është bërë edhe profilizimi i ShP të UÇK-së dhe ndarja e detyrave. Në qershor të vitit 1998 ShP i UÇK-së kishte këto drejtori: Drejtoria Personale e Shërbimit Informativ, Operativ, Financave, Logjistikës, Informimit, Administrimit Civil dhe Ndërlidhjes. Për më shumë shih Jakup Krasniqi, "UÇK-ja, një dhe e pandarë", kumtesë e lexuar në tryezën shkencore "Yjet e përflakur në themelet e UÇK-së", organizuar nga Zona e Pestë e TMK-së, më 31 janar 2001; Krasniqi, Kthesa e madhe, f.135-140; Avdi Raci, bisedë me autorin: Në fazën e luftës, gjendjes së krijuar në Kosovë, UÇK-jae shihte të domosdoshme krijimin e institucioneve gjithëpërfshirëse të spektrit politik. Gjithashtu, me qëllim të bashkërendimit të veprimtarisë politike në rrafshin kombëtar dhe pengimin e spekulimeve në këtë rrafsh, ShP i UÇK-së bën publik emrat e përfaqësuesve politikë të UÇK-së (Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Xhavit Haliti, Bardhyl Mahmuti, Faton Mehmetaj dhe Sokol Bashota). Adem Demaçit i jep besimin e plotë udhëheqës në këtë proces, formimin (Asamblesë Kombëtare) e institucioneve të Kosovës. Për më shumë shih <http://www.kosova.com/arkivi1997/arkivat.htm>, 13 gusht 1998. "Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK)", "Drejtoria Politike", "Deklarata politike nr. 7".

[11] Krasniqi, Kthesa e madhe, f.101-134.

\*Shtrirja e përgjegjesisë në aspektin gjeografik nuk nënkupton edhe përgjegjësinë operative, faktike në terren. Përgjegjësia është vetëm mbi territorin e kontrolluar (të organizimit dhe funksionimit) nga zonat operative.

[12] Sejdi Geci, bisedë me autorin.

[13] Haxhi Shala, Fadil Hoxha, Selajdin Beqiraj, bisedë me autorin.

[14] Nazmi Brahimaj, Hysen Dreshaj, bisedë me autorin.

[15] Emin Musa, Bajram Uka, Bajram Beqiri, bisedë me autorin.

[16] Kadri Kastrati, Nuredin Ibishi, Muhamet Latifi, bisedë me autorin.

[17] Imri Ilazi, Mentor Zejnullahu, bisedë me autorin.

[18] Shemsi Sylja, bisedë me autorin.

[19] Brigadat e zonave operative kanë qenë të koduara apo shifruara sipas renditjes së tyre. Kodifikimi apo shifrimi ka vazhduar nga organizimi para vendimit të 18 nëntorit të vitit 1998. Sqarim, në Zonën Operative të Drenicës, Brigada 114 "Fehmi Lladrovci", numri i parë (1) tregon Zonën e parë e që ishte Kosova, numri i dytë (1) tregon Zonën Operative të Drenicës apo Zonën e Parë dhe numri i tretë (4) tregon numrin e brigadës së krijuar sipas radhës.

\*Zonat operative kishin një strukturë organizative sipas standardeve të ushtrive të kohës, e cila përbëhej nga: Komandanti i Zonës, zëvendëskomandanti dhe shefi i Shtabit.

Shtabi drejtohej/komandohej nga shefi i Shtabit dhe përbëhej nga sektorët: Sektori i Personelit (Reparti kadrovik, Reparti për plotësimin e formacioneve dhe Reparti i mobilizimit), Sektori i Shërbimit Informativ (Reparti për analiza dhe plane dhe Reparti për mbledhjen e informatave), Sektori Operativ (Reparti operativ, Reparti i planifikimit dhe Reparti i mësimit), Sektori i Logjistikës (Reparti operativ i logjistikës, Reparti për mirëmbajtje, Reparti i furnizimit, Reparti i transportit dhe Reparti i mjekësisë), Sektori i Financave dhe Resurseve, Sektori i Ndërlidhjes dhe Komunikimit, Sektori për Moral dhe Sektori i Mbrojtjes Civile.

[20] Zhitia, UÇK-ZOLL, f. 42.

[21] Zhitia, UÇK-ZOLL, f. 220.

[22] Rregullore e përkohshme, Organizimi i jetës së brendshme në ushtri, kreu I, pika I. Betimi ushtarak. "Betimi ushtarak është një akt solemn, një ngjarje e shënuar në jetën e çdo ushtari me vlera të mëdha njerëzore e kombëtare, morale dhe politike". Për më shumë shih Krasniqi, Kthesë e madhe, f. 263.

[23] Zhitia, UÇK-ZOLL, f. 83. Numri i tri kategorive mund të ndryshojë, sepse ende ka luftëtarë që trajtohen

të zhdukur dhe prej atyre për të cilët nuk është zgjidhur statusi i invalidit apo i të lënduarit.

[24] Qemal Aliu, Agjencia e flakëve të luftës, Kosovapress, Prishtinë, 2004, f. 13-27. Filluan punën agjencia e lajmeve Kosovapress dhe radiostacioni Kosova e lirë, Kosova sot, Prishtinë, 5 janar 1999. Sipas vendimit të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së, të 13 nëntorit 1998, pas përgatitjeve teknike dhe kompletimit me kuadro profesionale, më 4 janar 1999, në fshatin Berishë fillojnë punën dy institucionet e rëndësishme informative. Ishin këto agjencia e lajmeve Kosovapress dhe radioja Kosova e lirë. Agjencinë e lajmeve e udhëhoqi Berat Luzha, kurse radion Ahmet Qeriqi. Në stafin drejtues të këtyre dy institucioneve ishin angazhuar redaktorë, gazetarë e folës si: Martinë Çuni, Qemal Aliu, Nezir Myrtaj, Isa Krasniqi, Nysret Pllana, Ismat Sopi, Habib Zogaj, Besnik Berisha, Valdet Hoti, Metë Bytyçi, Fatmir Dugolli, Riza Berisha etj. Kushtet e luftës nuk lejonin që puna e agjencisë së lajmeve të rumbullakohej në Kosovë, prandaj në Cyrih të Zvicrës u themelua zyra e agjencisë, të cilën e drejtonte Skënder Krasniqi e ku punonin Bekim Krasniqi e Isak Zhitia. Ndihmesë të madhe në funksionimin e kësaj zyre kanë dhënë: Xhevdet Thaçi, Ilaz Zhitia, Blerim Ejupi, Rexhë Abazi, Fisnik Cukaj, Sabit Veseli, Vesel Krasniqi etj. Kjo zyrë bënte plasimin e lajmeve që vinin nga Kosovapress-i në Kosovë e, në shumë raste, shkaku i kushteve që mbretëronin në Kosovë, këto informacione përcilleshin direkt nga përgjegjësit për informim të zonave të UÇK-së. Skënder Krasniqi pas një kohe të shkurtër kishte arritur që ta hapë përfaqësinë edhe në Tiranë. Në Tiranë përgjegjës caktohet Bekim Çollaku, bashkëpunëtorë Isa Blumi, Iliriana Tahiraj e Naile Selimaj. Kosovapress-i, gjithashtu, kishte korrespondentin në Bruksel, Ekrem Krasniqin dhe në Nju-Jork, Naim Balidemajn. Në Prishtinë, gjithashtu, ishte hapur zyra e Kosovapress-it. Përgjegjës ishte Nuhi Paçarizi, bashkëpunëtorë Jeton Rexha dhe Zenel Hajrizi.





**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Franca mposhti Marokun, i bashkohet në finale Argjentinës



**AL KHOR, 14 DHJETOR** - Franca është kualifikuar në finale të Kupës së Botës, pasi në gjysmëfinale e mposhti Marokun me rezultat 2-0. Franca të dielën do të sfidojë Argjentinën në super duelin që pritet të dhurojë

emocione. Do të jetë një përballje mes Kylian Mbappe dhe Lionel Messi, pasi sulmuesi francez fillimisht ka mposhtur shokun e ekipit Hakimi. Franca fitoi në shifrat 2-0, edhe pse në fakt në lojë nuk është se ishte aq

protagonist. "Gjelat" e nisën me gol që në minutën e 5-të. Pas një rrëmuje në zonën e Marokut, Theo Hernandez përfiton brenda zonës duke shënuar me një prekje të lehtë me të majtën. Maroku reagon mjaft mirë duke

luajtur mjaft mirë, duke krijuar shanse pafund në portën e Lloris, por fati nuk do të ishte në anën e tyre. Në pjesën e dytë, marokenët do të ishin më të lodhur, ndërkohë që Franca do të përfitonte për të vulosur shifrat.

Kampionët në fuqi realizojnë pas një aksioni fantastik në minutën e 79-të, me Kolo Muani që e kishte lojë fëmijësh dërgimin e topit në rrjetë. Minutat e fundit ishin sa për statistika, pasi Maroku nuk gjeti dot golin e nderit.

## Licencohen Federata e Mundjes dhe e Triathlonit



Prishtinë, 14 dhjetor - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku, ka nënshkruar licencat e radhës për federatat sportive sipas udhëzimit të ri administrativ për licencimin e federatave sportive. MKRS-ja ka njoftuar se pas rekomandimit pozitiv të komisionit për licencim në kuadër të Ministrisë së Sportit, ministri Çeku i ka dorëzuar

zyrtarisht licencën për ushtrimin e veprimtarisë kryetarit të Federatës së Mundjes, Naim Muja dhe kryetarit të Federatës së Triathlonit, Vedat Tërmmkoll. MKRS-ja i ka uruar dy federatat dhe u ka uruar suksese në veprimtarinë e tyre. Deri më tani janë licencuar Federata e Pingpongut, Federata e Xhudos, Federata e Hendbollit, Federata e

Sportit Shkollor, Federata e Mundjes, Federata e Triatlonit dhe ajo e Volejbollit ka marrë rekomandimin pozitiv. "Gjithsej 20 federata të tjera janë aktualisht në proces të licencimit. Përmes këtij procesi po e konsolidojmë integritetin sportiv dhe po i fuqizojmë standardet e qeverisjes së mirë brenda organizatave të sportit", ka thënë ministri Çeku.

## FBK-ja dënon Prishtinën dhe Trepçën me nga 2 000 euro

**PRISHTINË, 14 DHJETOR** - Komisioni i Garave i Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) bëri me dije dënimet për finalistët e Superkupës së Kosovës. Finalja e Superkupës së Kosovës u karakterizua me incidente të shumta, incidente këto që i detyruan të reagojnë organet kompetente për dhunën e shfaqur nga tifozët. Pas shqyrtimit, KG i FBK-së ka marrë vendim që t'i dënojë Sigal

Prishtinën dhe Trepçën me nga 2 000 euro. Por, ky nuk është dënimi i vetëm për Sigal Prishtinën, pasi që bardhekaltrit janë suspenduar me një ndeshje pa shikues. Kjo gjë vjen si pasojë e ndezjes së mjeteve piroteknike në parket ose në afërsi, të cilat ndërprejnë ndeshjen për 15 minuta. Ndërkaq, dënimet me nga 2 000 euro secila skuadër i merr si pasojë e shkeljes së neneve 49.4

(600 euro), 49.7 (400 euro) dhe 49.9 (1 000 euro). Neni 49.4: Hedhja e gjësendeve të forta që mund të shkaktojnë lëndime të rënda dënohet me 600 euro. Neni 49.7: Animi dhe sjellja jospportive e shikuesve ndaj policisë, sigurimit, institucioneve, FBK-së etj. dënohet me 400 euro. Neni 49.9: Largimi në zhveshtore pas vërejtjes së parë nga gjyqtari i parë (5-minuta) dënohet me 1 000.00 euro.



## Broja: Do të rikthehem më i fortë

LONDËR, 14 DHJETOR - Sulmuesi i Kombëtares së Shqipërisë, Armando Broja, pësoi një lëndim të rëndë në miqësore me Chelsean, duke bërë që ta humbasë pjesën e mbetur të sezonit. Me anë të një postimi në

rrjetet sociale, sulmuesi kuqezi falënderon të gjithë që e kanë mbështetur, duke premtuar se do të rikthehet më i fortë. "Më vjen keq që më duhet ta mbyll kështu vitin 2022. Ishte e vështirë për të

përpunuar gjithçka gjatë ditëve të fundit, por jam i vendosur se do të rikthehem më i fortë dhe më mirë se më parë. Secili ka rrugëtimin e tij drejt majës. Kjo është vetëm një pengesë e vogël për gjërat

e mira që do të vijnë në të ardhmen. Faleminderit të gjithëve që keni dërguar mesazhe mbështetëse! Do të thotë shumë. I vlerësoj të gjitha. Do të kthehem së shpejti", ka thënë 21-vjeçari Armando Broja.



## Messi: Finalja, ndeshja ime e fundit në Botëror

DOHA, 14 DHJETOR - Lionel Messi është një hap larg ëndrrës së tij më të madhe, triumfit me Argjentinën në Kupën e Botës. Ky trofe do ta kurorëzonte Messin si më të madhin e të gjithë kohëve. Kapiteni argjentinës ka konfirmuar se finalja e së dielës do të jetë ndeshja e fundit me fanellën "bardhekaltër" në Kupën e Botës. "Jam krenar që do të mund ta përfundoj karrierën time në Kupën e Botës duke luajtur në këtë finale. Ajo që po përjetoj është diçka emocionuese. Me siguri e diela do të jetë ndeshja ime e fundit në një Kupë Bote. Duhet të kalojnë shumë vjet derisa të vijë Botërori i radhës (2026) dhe nuk mendoj se do të jem. Kështu që shpresoj ta përfundoj në mënyrën më të mirë", ka thënë Messi.

Trajneri i Argjentinës, Lionel Scaloni, nuk ka dyshim se Lionel Messi është futbollisti më i mirë i të gjitha kohëve. Messi u bë golashënuesi më i mirë i Argjentinës në Kupën e Botës me penalltinë e tij në pjesën e parë



përpara se të asistonte Julian Alvarez më vonë në ndeshje. "Ndonjëherë mund të duket sikur ne e themi vetëm këtë si argjentinës, por nuk kam asnjë dyshim që ai është më i miri.

Çdoherë që ai luan është një burim i madh motivimi për bashkëlojtarët e tij. Nuk ka mbetur asgjë për të thënë për Messin. Është privilegj ta kesh atë", ka thënë Scaloni.

## Milwaukee mposhti kampionët, Lakersat dorëzohen pas kohës shtesë

MILWAUKEE, 14 DHJETOR - Milwaukee fitoi me rezultat 128-111 ndaj kampionëve të Golden States, duke konsoliduar vendin e dytë në Konferencën e Lindjes. Ndeshje e dominuar nga Bucks, ku u dallua Antetokounmpo me 30 pikë e 12 rebounde, mbështetur edhe nga Portis me 25 pikë e 11 rebounde. Bostoni rikthehet te fitorja, duke mundur me rezultat 122-118 Lakersat pas kohës shtesë, në një përballje të ekuilibruar deri në fund. Tatum me 44 pikë ishte lider në fushë për Celticsin, më i miri në



parket, duke i bërë të pavlefshme 37 pikët e Davisit dhe 33 të LeBronit. Vijnë kriza e Phoenixit, që pëson humbjen e pestë radhazi dhe humbet terren në renditje. Suns u mund me shifrat 111-97 nga

Houstoni (Green 26 pikë). Philadelphia, falë 31 pikëve të Joel Embiidit, mundi me rezultat 123-103 Sacramento, ndërsa Uah Jazzi mposhti me rezultat 121-100 New Orleans (Beasley 21 pikë).

### REZULTATET

Philadelphia - Sacramento	123-103
Milwaukee - Golden State	128-111
Houston - Phoenix	111-97
Utah Jazz - New Orleans	121-100
Lakers - Boston	118-122

### SHKURT

#### Dumani konfirmon largimin nga Prishtina

Gentrit Dumani nuk do të jetë më pjesë e skuadrës së Prishtinës. Lajmin e dha vetë futbollisti me anë të një postimi në "Facebook". "Nga sot e tutje nuk do të jem pjesë e 'FC Prishtinës'. Një falënderim për korrektësinë e treguar nga kryesia e klubit ndaj meje dhe faleminderit për të gjithë bashkëlojtarët dhe tifozët 'Plisat'", ka shkruar Dumani.

#### Modriqi: Shpresojmë që Messi ta fitojë këtë Botëror

Mesfushori i Kroacisë, Luka Modriqi, shpreson që Lionel Messita ta fitojë Kampionatin Botëror. Pas eliminimit të Kroacisë, Modriqi theksoi se Messi po e tregon veten në secilën ndeshje. "Shpresojmë që Messi ta fitojë këtë Botëror. Ai është lojtari më i mirë në histori dhe e meriton. Ai po bën një Botëror të madh. Ai po tregon cilësitë dhe madhësinë e tij në çdo ndeshje", ka thënë Modriqi.

#### Ten Hag: Rashfordi nuk largohet nga Unitedi

Paris Saint-Germain ka treguar interesim për sulmuesin e Manchester Unitedit, Marcus Rashford. Lidhur me të ardhmen e sulmuesit anglez foli edhe trajneri Erik ten Hag, duke konfirmuar se Rashfordi do të jetë në "Old Trafford" deri në përfundim të kontratës. "Ai duhet të marrë një vendim, kështu që ne vetëm mund t'i tregojmë se Manchester Unitedi është klubi më i mirë për të vazhduar. Ai ka një vit e gjysmë kontratë dhe, po, Rashfordi do të jetë këtu deri në fund të saj", ka thënë Rashfordi.

#### NBA: Trofeu MVP do të marrë emrin e ikonës së basketbollit

National Basketball Association (NBA) ka paraqitur 6 trofe, të dizajnuar dhe që u janë dedikuar disa prej legjendave të këtij sporti. Këto trofe do të dorëzohen në fund të sezonit në një ceremoni speciale. Trofeu MVP (Most Valuable Player) do të quhet "Trofeu Michael Jordan" dhe do t'i jepet si gjithnjë basketbollistit më të mirë, ndërsa trofetë e tjerë do të kenë emrat e disa prej pionierëve të këtij sporti që kanë kontribuar në vendosjen e standardeve të jashtëzakonshme në NBA. "Koleksioni ynë i ri i trofeve do të festojë disa nga basketbollistët më të mëdhenj në historinë e NBA-së", ka thënë komisioneri Adam Silver. "Ne i vlerësojmë lojtarët më të mirë të sezonit, duke i nderuar edhe ata që kanë qenë legjenda ndër vite", u shpreh Silver.

## Shumë klube në garë për Ramosin, Benfica kërkon 120 milionë euro

Shumë klube menjëherë kanë shprehur interesim për sulmuesin e Portugalisë, Gonçalo Ramos. Mirëpo klubi

portugez, Benfica, nuk është gati ta lirojë sulmuesin vetëm nëse ndonjë klub e paguan shifrën e klauzolës prej 120 milionë

eurosh. Klubet e interesuara për 21-vjeçarin janë Manchester Unitedi, Paris Saint-Germain, Bayern Munchen, Wolves dhe

Newcastle United. Ramosi ka kontribuar me 7 gola dhe 1 asistim në 10 paraqitje me Benficën këtë sezon, pa harruar

pesë gola në gjashtë ndeshje të Ligës së Kampionëve, ndërsa shënoi edhe tri gola në Kupën e Botës.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 03/2021 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit (shpallur në Gazetën Zyrtare më 16.09.2021); lidhur me nenin 26.4 të Rregullores (ZKA) 02/2021 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2022 (i ndryshuar/plotësuar), si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr. 2525 të datës 09.12.2022, Zyra Kombëtare e Auditimit ri shpall:

### KONKURS

<b>1. Pozita:</b>	<b>Auditor për teknologji të informacionit</b>
<b>Numri i referencës:</b>	ATI/ZKA/25-12/22
<b>Grada:</b>	ZKA-A7
<b>Numri i pozitave:</b>	Një (1)
<b>Kohëzgjatja e emërimit:</b>	Me kohë të pacaktuar

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Kryen auditime të sistemeve të informacionit në koordinim me UE, sipas planit vjetor, rregullave dhe metodologjisë së ZKA-së, Kodit të Etikës dhe në pajtim me Standardet Ndërkombëtare dhe i raporton udhëheqësit të ekipit dhe Drejtorit të Departamentit të Auditimit;
- Ndihmon Udhëheqësin e ekipit dhe koordinohet rreth procesit auditues si dhe komunikon/konsultohet rregullisht me UE dhe Drejtorin e Departamentit dhe raporton për arritjen e objektivave sipas planit të aprovuar nga Drejtori i departamentit;
- Kryen hulumtime dhe analizë në fushën e sistemeve të informacionit në sektorin publik dhe bën propozimin e temave audituese për planifikimin strategjik dhe atë vjetor të ZKA-së;
- Merr pjesë aktive në planifikim/parastudim dhe kryen vlerësimin e rreziqeve për sistemet e informacionit të audituara/monitoruara sipas fushave të përcaktuara nga UE dhe pjesëmarrje në përcaktimin e objektivave, fushës audituese si dhe kriterëve dhe metodave të auditimit;
- Komunikon mirë brenda ekipit dhe me entitet, kryen detyrat e përcaktuara nga UE dhe koordinohet në fazat e procesit auditues (planifikim, ekzekutim dhe raportim) dhe merr pjesë aktive në takime, intervista dhe diskutime me entitetin;
- Kryen hulumtime dhe analiza të sistemeve dhe të dhënave dhe siguron dokumentimin e tyre si dhe shkrimin e gjetjeve duke përfshirë elementet-kriterin, gjendjen, shkakun dhe efektin/rrezikun. Siguron dëshmi të mjaftueshme duke nxjerrë përfundime/konkluzione të bazuara dhe dhënien e rekomandimeve;
- Përgatit Letrat e Punës dhe Memo përmbledhëse lidhur me auditimin e fushës/komponentës audituese të përcaktuar nga udhëheqësi. Krijon dosjen/dëshmitë e auditimit dhe bënë indeksimin e tyre sipas kërkesave të UE dhe rregullave të ZKA;
- Ofron mbështetje për UE në hartimin e Draft raportit dhe në proceset e rishikimit (zbatimin e komenteve), në finalizimin e raportit të auditimit dhe aktivitetet pas raportuese si dhe merr pjesë në prezantime dhe seminare ndërlidhur me atë raport;
- Ofron përkrahje dhe bashkëpunim nëse kërkohet në nivel të ZKA-së, në mënyrë që të ofrojë mbështetje dhe duhur lidhur me sistemet e TI për fushat që auditohen nga stafi tjetër i zyrës (për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë) si dhe kontribuon në RVA;
- Siguron se aktivitetet audituese kryhen në pajtim me kërkesat e ZKA përfshirë punën e organizuar online/nga shtëpia, zbaton manualin e auditimit dhe siguron se përdoren sistemet e vendosura për auditim në ZKA dhe sistemet e veçanta për auditimet e SI-së;
- Ruan dhe azhuron njohuritë profesionale dhe teknike përmes trajnimeve dhe Edukimit të Vazhdueshëm Profesional si dhe tregon gatishmëri për të zhvilluar vetveten në fushat e dakorduara me Drejtorin gjatë vlerësimit të performancës;
- Kryen edhe detyra të tjera profesionale të kërkuara nga UE dhe nga Drejtori i departamentit.

#### Kualifikimet Themelore:

- Diplomë fakulteti në fushat relevante të TI-së;
- Tre (3) vite përvojë pune profesionale në fushën e TI-së, preferohet përvojë pune në fushën e auditimit;
- Preferohet certifikim për auditor nga fusha e TI-së;
- Preferohet njohuri e gjuhës angleze.

#### Shkathtësitë e kërkuara:

- Njohuri të theksuara në fushën e auditimeve;
- Shkathtësi në organizim të punës dhe përmbushje të objektivave;
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit;
- Njohuri për mbikëqyrje efektive të punës profesionale;
- Aftësi për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e institucionit dhe integritetin e tij;
- Aftësi motivuese, dhe komunikuese në ekip;
- Të posedoj aftësi të mira ndër-personale.

#### Informata të përgjithshme për kandidatë:

Pensimi i pagës për pozitë të shpallura bëhet në përputhje me rregullat e brendshme të punës së Zyrës Kombëtare të Auditimit.

#### Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

#### Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore dhe përvojën e punës;
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë;
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (nëse aplikohet);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (online) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit, afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 30.12.2022 ora 16.00.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën [www.zka-rks.org](http://www.zka-rks.org) dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokument mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

#### Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

U skladu sa Članom 15.2 Zakona Br. 05/L-055 o Generalnom revizoru i Nacionalnoj kancelariji revizije Republike Kosovo, kao i Članom 5, 6 i 7 Pravilnika (NKR) 03/2021 ZA o Prijemu i Karijeru u Nacionalnoj kancelariji revizije (objavljeno u Službenom listu 16.09.2021), vezano za Član 26.4 Pravilnika (NKR) 02/2021 o Klasifikaciji radnih mesta, Godišnjem planu zapošljavanja kao i Odluci Generalne revizorke sa Br. 2525 datuma 09.12.2022 o popunjavanju slobodnog radnog mesta, Nacionalna kancelarija revizije objavljuje:

### KONKURS

<b>1. Pozicija:</b>	<b>Revizor informacione tehnologije</b>
<b>Broj reference:</b>	ATI/ZKA/25-12/22
<b>Koeficijent:</b>	ZKA-A7
<b>Broj pozicija:</b>	Jedan (1)
<b>Trajanje imenovanja:</b>	Na neodređeno vreme

#### Dužnosti i odgovornosti:

- Završava revizije sistema informacije u koordinaciji sa VT, prema godišnjem planu, pravilnicima i metodologiji NKR-a, koda etike i u skladu sa međunarodnim standardima i izveštava vođi tima i direktoru departmana revizije;
- Pomaže vođu tima i koordinira se oko procesa revizije kao i komunicira/konsultuje se redovno sa VT i direktorom departmana i izveštava o dostignućima ciljeva prema odobrenom planu od strane direktora departmana;
- Vrši istraživanja i analize u polju sistema informacija u javnom sektoru i predlaže revizijske teme o strateškom i godišnjem planiranju NKR-a;
- Aktivno učestvuje u planiranju/pred studiji i vrši procenu rizika za revidirane/pračene informacione sisteme prema oblastima definisanim od strane VT i učešće u definisanju ciljeva, oblasti revizije kao i kriterijuma i metoda;
- Dobro komunicira unutar tima i sa subjektom, obavlja zadatke definisane od strane EU i koordinira u fazama procesa revizije (planiranje, izvršenje i izveštavanje) i aktivno učestvuje u sastancima, intervjuima i diskusijama sa subjektom;
- Vrši istraživanje i analizu sistema i podataka i obezbeđuje njihovu dokumentaciju kao i pisanje nalaza uključujući kriterijume-elemente, stanje, uzrok i efekat/rizik. Pruža dovoljno dokaza donoseći zaključke/konkluzije osnovane u davanju preporuka;
- Pružava dovoljno dokaza tako što donosi utemeljene zaključke/konkluzije osnovane u davanju preporuka;
- Priprema radne dokumente i sažetke memoranduma koji se odnose na reviziju oblasti/komponente koju definiše vođa. Kreira revizijski fajl/dokaze i vrši njihovo indeksiranje u skladu sa zahtevima VT i pravilima NKR-a;
- Pružava podršku VT-u u izradi Nacrta izveštaja i u procesima pregleda (implementaciji komentara), u završavanju revizorskog izveštaja i aktivnosti posle izveštavanja, kao i učestvuje u prezentacijama i seminarima u vezi sa tim izveštajem;
- Pružava podršku i saradnju ako je potrebno na nivou NKR -a, kako bi se pružila odgovarajuća podrška u vezi sa IT sistemima za oblasti koje revidiraju drugo kancelarijsko osoblje (za finansijske revizije i revizije usklađenosti), kao i doprinos GIR;
- Obezbeđuje da se aktivnosti revizije sprovede u skladu sa zahtevima NKR-a, uključujući organizovani onlajn/kucni rad, implementira priručnike revizije i obezbeđuje da se koriste sistemi uspostavljeni za reviziju u NKR-u i posebni sistemi za revizije IS;
- Sačuva i ažurira stručna i tehnička znanja kroz obuke i kontinuirano stručno obrazovanje, kao i pokazuje spremnost da se razvija u oblastima dogovorenim sa direktorom tokom procene učinka;
- Obavlja i druge stručne poslove na zahtev VT i direktora departmana.

#### Osnovne kvalifikacije:

- Diploma fakulteta iz relevantnih IT oblasti;
- Tri (3) godine profesionalnog radnog iskustva u oblasti IT, poželjno radno iskustvo u oblasti revizije;
- poželjna sertifikacija IT revizora;
- Poželjno poznavanje engleskog jezika.

#### Potrebne veštine:

- Savršeno znanje u oblasti revizije;
- Veštine u organizaciji rada i ispunjenju ciljeva;
- Znanje pravnih akata važećih u Nacionalnoj kancelariji revizije;
- Znanje o efektivnom nadzoru profesionalnog rada;
- Sposobnost da bi predstavljali i branili interese institucije i njenog integriteta;
- Motivacione i komunikativne sposobnosti u timu;
- Dobre međuljudske veštine.

#### Opšte informacije za kandidate:

Naknada plate za objavljene položaje vrši se u skladu sa internim pravilima rada Nacionalne Kancelarije Revizije.

#### Procedura apliciranja:

Procedura apliciranja je otvorena za sve kandidate koji ispunjavaju kriterijume konkursa. Nacionalna Kancelarija Revizije pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Kosova i dočekuje kandidate iz svih zajednica na Kosovu

#### Kandidati trebaju dostaviti sledeća potrebna dokumenta:

- službeni Formular NKR-a za apliciranje;
- kopiju lične karte Republike Kosova;
- dokaze o školskoj spremi i radnom iskustvu;
- dokaz iz suda da nije osuđivan pravnom odlukom;
- dokaz da ne postoji disciplinska mera za razrešenje sa funkcije javnog službenika (ako je primenljiva);

Samo službeni obrazac za konkurisanje će se uzimati u obzir. Formulari za konkurisanje dostavljeni nakon isteka roka se ne razmatraju a nepotpune će biti odbijene. Biće kontaktirani samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume.

Konkurs ostaje otvoren petnaest (15) dana od dana objavljivanja na elektronskim medijama (onlajn) i na internet stranici Nacionalne Kancelarije Revizije, zadnji rok za podnošenje dokumentacije 30.12.2022 godine do 16.00 časova.

Obrasci za aplikaciju mogu se preuzeti na recepciji NKR-a ili se mogu preuzeti sa veb stranice NKR-a na adresi [www.zka-rks.org](http://www.zka-rks.org) i dostavljaju se u Odeljenju za administriranje dokumenata Nacionalne Kancelarije Revizije na adresi: Naselje: Arbëria, ul. "Ahmet Krasniqi" br. 210 – Priština, svakog radnog dana od 08:00 – 16:00, Obrazac i prateća dokumenta se takođe mogu dostaviti e-poštom na [rekrutimi@oagks.org](mailto:rekrutimi@oagks.org) ili preko pošte. Za detaljnije informacije možete se obratiti na br.tel. 038/606-004, ext:1025.

#### Beleška:

Aplikacije poslate poštom, koje imaju poštanski žig na uručanju izvršenom poslednjeg dana roka za prijavu, smatraće se validnim i biće uzete na razmatranje.





# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Artan Hana nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV dhe Diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha".

- "Gazeta Newborn" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb: 810748981.

- Anton Bushaj nga Novosella e Ulët KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.F "Engjëll Gjoni" Novosell e Ulët KK Gjakovë nga kl. I-VIII

- Mihrem Bajra shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Floridan Begaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Dëshmorët e Zhurit " Zhure.

- Myrvete Kurti shpalle te pavlefshme dëftesën nga klasa 1-8 te shkollës fillore Musa Hoti ( Ish Meto Bajraktari).

- D.P.H " Break Time Caffe" shpalle te pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb : 70916479.

- Albina Hoxhaj shpalle te pavlefshme dëftesën dhe diplomën e SHMLM " De Xheladin Deda".

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.



ROYAL CROWN  
**RC**  
cola

## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1908

**RC**  
cola  
Columbus, Georgia, USA  
Since 1908  
0.5L